# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2026 – Numri: 69

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E premte, 3 prill 2026**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 3.4.2026 | Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar........................ | 5151 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 212, datë 1.4.2026 | Për përcaktimin e masës së financimit në buxhetin e vitit 2026 për bashkësitë fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave........................ | 5151 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 1.4.2026 | Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga "Porti Detar Sarandë" sh.a. tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për Drejtorinë e Përgjithshme Detare, të një pjese të pasurisë nr. 26/72, në zonën kadastrale 8641, Sarandë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 586, datë 10.9.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listave të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror", të ndryshuar........................ | 5152 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 214, datë 1.4.2026 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 159, datë 17.3.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formës e të përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për të huajt pa shtetësi, të dokumentit të udhëtimit, lejes së kalimit, të dokumentit të përkohshëm, dublikatës së lejes së qëndrimit e të lejes unike, si dhe të letërnjoftimit për të huajt" ........................ | 5155 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 215, datë 1.4.2026 | Për një shtesë në vendimin nr. 450, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejeve të qëndrimit për të huajt" ........................ | 5160 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 1.4.2026 | Një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar........................ | 5161 |



Adresa: Rruga "Nikolla Jorga", Tiranë: Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel. +355 4 24 27 006

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 217, datë 1.4.2026 | Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar........ | 5161 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 219, datë 1.4.2026 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 684, datë 23.10.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i nënstacionit 400 kV Fier'", të ndryshuar............. | 5166 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 220, datë 1.4.2026 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Parku natyror 'Liqeni i Ulzës' dhe zona e mbrojtur përreth tij", me vendndodhje në Bashkinë Mat........ | 5167 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 221, datë 1.4.2026 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Studim, projektim, aksi rrugor Elbasan–Lekaj, korridori 8, loti I (faza I, II, III) Elbasan–Papër"........ | 5168 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 222, datë 1.4.2026 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Rikonstruksion, rruga 'Marin Beçikemi', Bashkia Shkodër"............. | 5172 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 225, datë 1.4.2026 | Për përcaktimin e masës së përfitimit, kritereve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2026........ | 5173 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 227, datë 1.4.2026 | Për një ndryshim në vendimin nr. 707, datë 21.11.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër–Fier", të ndryshuar, dhe për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për sportin dhe turizmin të pasurisë nr. 284/5, me vendndodhje në zonën kadastrale 3774, Rrogozhinë........ | 5175 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 1.4.2026 | Për një ndryshim në vendimin nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar", të ndryshuar... | 5178 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 230, datë 1.4.2026 | Për përcaktimin e modelit të financimit të buxhetit për shkencën dhe kërkimin shkencor........ | 5178 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 231, datë 1.4.2026 | Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2026–2028........ | 5181 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 233, datë 1.4.2026 | Për një ndryshim në vendimin nr. 643, datë 5.10.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Komitetit për Planifikimin Kombëtar Spitalor"......... | 5182 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 235, datë 1.4.2026 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 712, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore", të ndryshuar........................................................... | 5183 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 237, datë 1.4.2026 | Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Sarandë.................................................................... | 5184 |
| Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 378/4, datë 30.3.2026 | Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 662, datë 13.10.2022, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të 'Unazës së madhe' Tiranë nga 'Sheshi Shqiponja' – 'Bulevardi i Ri' dhe 'Rikualifikimi i Unazës Lindore 4,5,6", i ndryshuar"...................... | 5189 |

**AKT NORMATIV**
**Nr. 1, datë 3.4.2026**

**PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 61/2012, “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë,” të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Pas pikës 9, të nenit 109, “Dispozita kalimtare”, shtohet pika 10, me këtë përmbajtje:

“10. Përjashtimisht, në rastet kur në bazë të vendimit të Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit (në vijim Bordi), i ngritur në përputhje me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, çmimi tavan për shitjen me pakicë për benzinën dhe gazoilin është mbi nivelet e mëposhtme:

a) 200 lekë/litri për benzinën;

b) 220 lekë/litri për gazoilin,

niveli i akcizës së këtyre produkteve zbatohet në masën 80% të niveleve të caktuara në shtojcën nr. 1, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë,” të ndryshuar, si më poshtë vijon:

- Benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249, niveli i akcizës është 31.50098 lekë/litri;
- Gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944, niveli i akcizës është 31.50098 lekë/litri.”.

Neni 2
**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare, si dhe i shtrin efektet përgjatë kohëzgjatjes së situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve në territorin e Republikës së Shqipërisë, të shpallur me vendimin nr. 186, datë 19.3.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 212, datë 1.4.2026**

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT NË BUXHETIN E VITIT 2026 PËR BASHKËSITË FETARE, QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME KËSHILLIN E MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 2, pikat 2, 3, 4, pika 2, 5, pika 1, e 6, të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009, “Për financimin, nga buxheti i shtetit, të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, dhe të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e financimit, prej 203 000 000 (dyqind e tre milionë) lekësh, nga buxheti i vitit 2026, e miratuar për të mbështetur financiarisht bashkësitë fetare, përdoret, si më poshtë vijon:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 57 300 000 (pesëdhjetë e shtatë milionë e treqind mijë) lekë, të ndarë në:

i. 28 200 000 (njëzet e tetë milionë e dyqind mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 94 (nëntëdhjetë e katër) punonjës të administratës;

ii. 29 100 000 (njëzet e nëntë milionë e njëqind mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 97 (nëntëdhjetë e shtatë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 48 600 000 (dyzet e tetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, të ndarë në:

i. 24 600 000 (njëzet e katër milionë e gjashtëqind mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 82 (tetëdhjetë e dy) punonjës të administratës;

ii. 24 000 000 (njëzet e katër milionë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 80 (tetëdhjetë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 48 600 000 (dyzet e tetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, të ndarë në:

i. 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore, për 50 (pesëdhjetë) punonjës të administratës;

ii. 33 600 000 (tridhjetë e tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 112 (njëqind e dymbëdhjetë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 48 500 000 (dyzet e tetë milionë e peseqind mijë) lekë, të ndarë në:

i. 9 000 000 (nëntë milionë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për 30 (tridhjetë) punonjës të administratës;

ii. 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë, si kontribut në ndërtimin e Teqesë së Shtufit, Gjirokastër;

iii. 11 500 000 (njëmbëdhjetë milionë e peseqind mijë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshatë Botërore, me qendër në Tiranë, dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit, që do të përdoret për të mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesëpreventivat e paraqitura prej saj në kërkesën për vitin 2026, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur.

2. Kalimi i fondit, i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, bëhet njëherësh, brenda muajit prill të vitit 2026.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 213, datë 1.4.2026**

## PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA "PORTI DETAR SARANDË" SHA TEK MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME DETARE, TË NJË PJESE TË PASURISË NR. 26/72, NË ZONËN KADASTRALE 8641, SARANDË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 586, DATË 10.9.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË INVENTARËVE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT U KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHOQËRIVE ANONIME DHE NDËRMARRJEVE TË SISTEMIT TË TRANSPORTIT DETAR DHE AJROR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga "Porti Detar Sarandë" sh.a. tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për Drejtorinë e Përgjithshme Detare, të pronës, me emërtimin "Kapiteneria e Portit, Sarandë", pjesë e pasurisë nr. 26/72, në zonën kadastrale 8641, Sarandë, sipas formularit 1 (një) fletë dhe planit të rilevimit 1 (një) fletë, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për ushtrimin e aktivitetit administrativ.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga sipërfaqja e përgjithshme e komponentit me emërtimin "Moli nr. 1", pjesë përbërëse e pronës, me emërtimin "Porti Detar Sarandë" sh.a., sipas listës 4, të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 586, datë 10.9.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listave të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve

të sistemit të transportit detar dhe ajror”, të ndryshuar.

3. Prona me emërtimin “Kapitaneria e Portit Sarandë” hiqet nga lista 5, e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 586, datë 10.9.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listave të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror”, të ndryshuar.

4. Drejtorisë së Përgjithshme Detare i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit, apo tjetërsimi i pasurisë së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme Detare, “Porti Detar Sarandë” sh.a. dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE**
**(Per inventarizimin e pronave te veçanta)**

Institucioni: DREJTORIA E PERGJITHSHEME DETARE

Identifikoi: **Barie Tahiri**
**Përgjegjese e Sektori të Financës**
Supervizoi: **Ferdoza Izvira**
Drejtoreshë e Financës dhe Sherbimeve Mbështetëse
Aprovoi: **Tomar Harizi Zv. Drejtor i Përgjithshëm në Munges dhe me Urdhër**
Nr.tel.0676865655

Fusha e perdorimit; Ambjente zyrash për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme Detare
**Kapiteneria e Portit Sarandë**

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones m2 | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 8641 SR F-9 | 26/72 | Ndërtesë +Truall | Kapiteneria e Portit të Sarandës | 332 | 145 | Ambjente zyrash të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për Kapitenerinë e Portit të Sarandë | *Drejtoria e Përgjithshme Detare* | Drejtoria e Përgjithshme Detare për Kapitenerinë e Portit të Saradës Nipt;L01921751A | Sipërfaqe totale e truallit brënda rrethimit 332m2, nga e cila kati përdhe është145m2,dhe tre katet sëbashku janë 435 m2 ndërtim(nga e cila 66m2 është verande ) |
| | | | | | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI:PORTI DETAR SARANDE DATE: 09.07.2025 QELLIMI: INVENTARIZIM/REGJISTRIM

VENDNDODHJA

BASHKIA SARANDE DVASHK:SARANDE ZONA KADASTRALE:8641 NUMRI PASURISE:26/72 INDEX HARTE:SR-G-9

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI I PASURISE: TRUALL SIP. E PASURISE:17396 $M^2$ SIP. E GJURMES SE NDERTIMIT:- $M^2$ NUMRI I KATEVE: NUMRI I PEMEVE:

X= 500182.23
Y= 4415158.49

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X= 500277.06
Y= 4415158.49




X= 500182.23
Y= 4415084.01

SHKALLA 1: 500

X= 500277.06
Y= 4415158.49

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID / NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERIU | | HARTË KADASTRALE | 26/72 | | |
| 2 | LINDJA | | HARTË KADASTRALE | 26/72 | | |
| 3 | JUGU | | HARTË KADASTRALE | 26/72 | | |
| 4 | PERENDIMI | | HARTË KADASTRALE | 26/72 | | |

*REALIZOI: ING. LEFTER SHUKA*

*Licensa nr. MK 1869/2 , dt.22.01.2018*

*NIPT: K31510532J*

NENSHKRIMI / VULA Lefter Shuka

Digitally signed by Lefter Shuka
Date: 2025.08.04 13:22:20 +02'00'

*REALIZOI PER ASHK*

SPECIALISTI : ________________

DVASHK ________________

NENSHKRIMI ________________

*KONFIRMOI*

PERGJEGJESI/DREJTORI

NENSHKRIMI / VULA ____________

**TEKNOLOGJIA E MATJEVE** :Terren,matje distancash,ortofoto

Kode per teknologjine e matjeve : **T-Terren;** Z-Zyre; **O-Ortofoto;** G-GPS; S-Stacion Total; **D-Matje Distancash**

**PERCAKTIMI I KUFIRIT** :P-Perfaqesues i Pronareve, HK-Harta Kadastrale

Kode per percaktimi i kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkise; HK-Harta Kadastrale

SHENIME TE VEÇANTA : Prona e Kapitenerisë Sarandë, pjesë e pasurisë 26/72, ZK 8641, është truall $332m^2$ dhe ndërtesë 3 katëshe me sipërfaqe $145m^2$ (total ndërtesë $435m^2$). Sipërfaqja e ndërtimit në katin përdhe është $145m^2$, kati i parë teknik $145m^2$, kati i dyte teknik $145m^2$ ($89m^2$ zyra +$56m^2$ verandë). Numri i pasurise percaktohet nga specialistet e ASHK ne perfundim te procesit.

*PRONARI/BASHKPRONARET:* *KERKUESI: DREJTORIA E PERGJITHSHME DETAR*

TOMOR HARIZI
ZV.DREJTOR I PERGJITHSHEM

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi i kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkise; HK-Harta Kadastrale

**VENDIM**
**Nr. 214, datë 1.4.2026**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 159, DATË 17.3.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E FORMËS E TË PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT PËR TË HUAJT PA SHTETËSI, TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT, LEJES SË KALIMIT, TË DOKUMENTIT TË PËRKOHSHËM, DUBLIKATËS SË LEJES SË QËNDRIMIT E TË LEJES UNIKE, SI DHE TË LETËRNJOFTIMIT PËR TË HUAJT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 17, të nenit 4, të pikës 7, të nenit 12, të pikës 3, të nenit 13, të pikës 2, të nenit 15, të pikës 2, të nenit 38, dhe të pikës 3, të nenit 96, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 159, datë 17.3.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formës e të përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për të huajt pa shtetësi, të dokumentit të udhëtimit, lejes së kalimit, të dokumentit të përkohshëm, dublikatës së lejes së qëndrimit e të lejes unike, si dhe të letërnjoftimit për të huajt", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1, pas fjalëve "... pa shtetësi..." shtohen "..., të lëshuar nga autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për përcaktimin e statusit të pashtetësisë, ...";

b) Anekset nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me anekset nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5, që i bashkëlidhen këtij vendimi;

c) Kudo në vendim, emërtimet "Ministri i Brendshëm" dhe "Ministria e Brendshme" zëvendësohen, përkatësisht, me "Ministri i Punëve të Brendshme" dhe "Ministria e Punëve të Brendshme".

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

ANEKS NR. 3

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT "LEJE KALIMI PËR TË HUAJT"

- Leja e kalimit për të huaj është letër në përmasat 210X297 (format A4);
- Pesha specifike e letrës që përdoret për leje kalimi është 100–120 gr./m$^2$;
- Dokumenti "Leje kalimi për të huajt" përmban këto elemente sigurie:
- Shtyp me bojë të padukshme (të dukshme vetëm nën veprimin e dritës UV);
- Numri i serisë 7-shifror me bojë fluoreshente;
- Leja e kalimit për të huajt ka përmbajtjen si formati në vijim.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**REPUBLIC OF ALBANIA**

**LEJE KALIMI PËR TË HUAJT**
**VETËM PËR NJË UDHËTIM**

**LAISSEZ PASSER FOR FOREIGNERS**
**FOR A SINGLE JOURNEY ONLY**

**No. XXXXXXX**

Autoriteti lëshues ________________________
Issuing authority

Mbiemri ________________________
Family name

Emri (at) ________________________
Given Names

Shtetësia e Mbajtësit ________________________
Citizenship of bearer

Fotografia
Photograph

Datëlindja ________________
Date of Birth

Gjinia ____________________
Sex

Vendlindja ________________
Place of Birth

Nenshkrimi i mbajtesit / Signature of bearer

Ky dokumenti është i vlefshëm vetëm për një udhëtim nga: ________________
në: ______________________
This document is valid for a single journey only as from: (Shtetit /State) to
(Shtetit /State)

Lëshuar ne, (Vendi), me_______(Data)
Issued at, (Place), on_________ (Date)

**Rezervuar për VIZE / Reserved for VISA**

E vlefshme deri me ___ (Data)
Valid until(Date)

Nënshkrimi i Nëpunësit Lëshues
Signature of issuing Officer

SHENIME / OBSERVATIONS

**Ky dokument është pronë e Shtetit Shqiptar**
**Autoritetet aeroportuale të vendeve transite janë të lutur të asistojnë personin e interesuar gjate procedurave te kalimit transitit, nëse është e nevojshme.**

**This document is property of Albanian State**
**The transit airport authorities are pleased to assist, if necessary, the interested person during the transit procedures.**

ANEKS NR. 4

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË PËRKOHSHËM PËR TË HUAJT

- Dokumenti i përkohshëm për të huajt është letër në përmasat 210x297 (format A4);
- Dokumenti i përkohshëm për të huajt ka përmbajtjen si në vijim:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT**
**DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN**
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin __________

**DOKUMENT I PËRKOHSHËM**
***Temporary document***

**PËR ZËVENDËSIMIN E:**
For the replacement of

**Dokumentit të udhëtimit për të huajt** ☐
*Travel document for foreigners*
**Lejes së kalimit për të huajt** ☐
*Laissez passer for foreigners*
**Letërnjoftimit për të huajt** ☐
*Identification card for foreigners*
**Lejes së qëndrimit për të huajt** ☐
Residence permit for foreigners

**TË DHËNAT E PERSONIT:**
***Personal data***

EMRI (AT), MBIEMRI ____________________
*First name (s), Family name*

Foto
Photograph

VENDLINDJA ____________ DATËLINDJA dd.mm.yyyy
*Place of birth* *Date of birth*

NUMRI IDENTITETIT PËR TË HUAJT (FID) __________________
*Foreigner Identity Number FID*

SHTETËSIA ________ GJINIA ________ GJENDJA CIVILE ________
*Nationality* *Sex* *Civil Status*

**TË DHËNAT E DOKUMENTIT TË HUMBUR / DËMTUAR:**

Nr. Dokumentit ________ Data e lëshimit ________ Data e skadimit ________
*No. of Document* *Date of issue* *Expire date*

Autoriteti lëshues ______________
*Issuing authority*________________

Ky dokument është i vlefshëm nga data ________ deri me datë ________
*This document is valid from date* ________ *until date* ________

DREJTORI
*DIRECTOR*

Nënshkrimi, Vula e Autoritetit
*Signature, Stamp of Authority*

ANEKS NR. 5

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT DUBLIKATË LEJE QËNDRIMI PËR TË HUAJT DHE DUBLIKATË LEJE UNIKE PËR TË HUAJT

- Dokumenti dublikatë leje qëndrimi/leje unike për të huajt është letër në përmasat 210x297 (format A4);
- Dokumenti ka përmbajtjen si në vijim:

**Nr.** ________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT**
**DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN**
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin___________

**DUBLIKATË LEJE QËNDRIMI PËR TË HUAJT**
*DUBUCATE RESIDENCE PERMIT OE FOREIGNERS*

**TIPI** _______
*Type*

EMRI (AT) MBIEMRI ____________________________
*First Name (s), Family name*

Foto
Photograph

VENDLINDJA ____________ DATËLINDJA dd.mm.yyyy
*Place of birth* *Date of birth*

NUMRI IDENTITETIT PËR TË HUAJT (FID)_______________
*Foreigner Identity Number FID*

SHTETËSIA __________ GJINIA ______ GJENDJA CIVILE_________
*Nationality* *Sex* *Civil Status*

MOTIVI I QËNDRIMIT ________________________________________________
*Purpose of Stay*

ADRESA NË SHQIPËRI _______________________________________________
*Address in Albania*

Kjo dublikatë leje qëndrimi është e vlefshme nga data dd.mm.yyyy, deri me datë dd.mm.yyyy
*This Dublicate of Residence Permit is valid from* dd.mm.yyyy, *until* dd.mm.yyyy

**DREJTORI**
*DIRECTOR*

________________

Nënshkrimi, Vula e Autoritetit
*Signature, Stamp of Authority*

Nr. ________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT**

**DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN**

Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin __________

**DUBLIKATË LEJE UNIKE PËR TË HUAJT**

*DUBLICATE SINGLE PERMIT OF FOREIGNERS*

**TIPI** __________
*Type*

Foto
*Photograph*

EMRI (AT), MBIEMRI ______________________
*First name (s), Family name*

VENDLINDJA __________ DATËLINDJA d d. m m .yyyy
*Place of birth* *Date of birth*

NUMRI IDENTITETIT PËR TË HUAJT (FID) ________________
*Foreigner Identity Number FID*

SHTETESIA ______________ GJINIA ________ GJENDJA CIVILE __________
*Nationality* *Sex* *Civil Status*

MOTIVI I QËNDRIMIT ________________________________________
*Purpose of Stay*

ADRESA NË SHQIPËRI ________________________________________
*Address in Albania*

Kjo dublikatë leje unike është e vlefshme nga data dd.mm.yyyy deri me date dd.mm.yyyy
*This Dublicate of Single Permit is valid from* dd.mm.yyyy *until* dd.mm.yyyy

DREJTORI
*DIRECTOR*

________________________
Nënshkrimi, Vula e Autoritetit
*Signature, Stamp of Authority*

**VENDIM**
**Nr. 215, datë 1.4.2026**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 450, DATË 29.6.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE TË PËRMBAJTJES SË LEJEVE TË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 32, dhe të pikës 11, të nenit 33/1, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1, të vendimit nr. 450, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së lejeve të qëndrimit për të huajt", shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Miratimin e formës së kartëqëndrimit të një anëtari të familjes së një shtetasi të Bashkimit Evropian, sipas aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

ANEKS NR. 3

KARTË QËNDRIMI PËR ANËTARIN E FAMILJES SË SHTETASIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT**
**DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN**
**Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin__________**

KARTË QËNDRIMI PËR ANËTARIN E FAMILJES SË SHTETASIT TË BASHKIMIT EVROPIAN
*RESIDENCE CARD FOR FAMILY MEMBER OF A EUROPEAN UNION CITIZEN*
*Seria dhe Numri i Kartës*
*Series and Card Number*
*BG 239200*

EMRI (AT), MBIEMRI ____________________
*First name (s), Family name*

VENDLINDJA __________ DATËLINDJA dd.mm.yy
*Place of birth* *Date of birth*

Foto
*Photograph*

SHTETËSIA __________ GJINIA __________
*Nationality* *Sex*

NUMRI I PASAPORTËS/DOKUMENT IDENTIFIKIMI ____________________
*Passport Number/ Identification document*

ADRESA E VENDBANIMIT ______________________________
*Residential Address*

FID NUMBER ________________
*Foreigner identification number*

Kjo kartë qëndrimi, është e vlefshme nga data dd.mm.yy deri më dd.mm.yy
*This Residence Card is valid from ____ until ___ .*

**DREJTORI I DVKM**
*Director*

______________________________

Nënshkrimi, Vula e Autoritetit

**VENDIM**
**Nr. 216, datë 1.4.2026**

## NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, dhe 25, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit "Lista e OKB-së", që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në listën e shkronjës "D", të titulluar "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida", hiqet 1 (një) kompani, renditur në shkronjën "a", sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për kompanitë e shpallura bashkëpunëtore të organizatave ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

NDRYSHIM NË LISTËN E KOMPANIVE TË SHPALLURA SI BASHKËPUNËTORE APO FINANCUESE TË TERRORIZMIT
SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT
(LISTA E OKB-së)

D. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Ndryshim në "Listën e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida":

1. AL-NUSRAH FRONT FOR THE PEOPLE OF THE LEVANT

Shënim. Gjenealitetet e tjera për kompaninë, emri i të cilës është renditur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

**VENDIM**
**Nr. 217, datë 1.4.2026**

## PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 3, pika 3, shkronja "c", e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 16, të kreut I, pas fjalëve "... (CFSP) 2025/1577 ..." shtohen "... (CFSP) 2026/421 ...".

2. Në aneksin 16, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2026/421, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian
AL Seria L
2026/421 19.2.2026

**VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2026/421**

**i 19 shkurtit 2026**

**që ndryshon Vendimin (CFSP) 2025/1577 që përditëson listën e personave, grupeve dhe subjekteve të mbuluara nga Qëndrimi i Përbashkët 2001/931/CFSP mbi zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti Nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Ndërsa:

(1) Më 27 dhjetor 2001, Këshilli miratoi Qëndrimin e Përbashkët 2001/931/CFSP [1].

(2) Më 29 korrik 2025, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2025/1577 [2]. Ky Vendim përcakton një listë të përditësuar të personave, grupeve dhe subjekteve për të cilat zbatohen masat në nenet 2 dhe 3 të Qëndrimit të Përbashkët 2001/931/CFSP.

(3) Këshilli ka përcaktuar që autoritetet kompetente sipas kuptimit të Nenit 1(4) të Qëndrimit të Përbashkët 2001/931/CFSP kanë miratuar vendime në lidhje me një entitet të përfshirë në akte terroriste sipas kuptimit të Nenit 1(3) të atij Qëndrimi të Përbashkët, dhe se masat në Nenet 2 dhe 3 të atij Qëndrimi të Përbashkët duhet të zbatohen ndaj atij entiteti

(4) Lista e personave, grupeve dhe subjekteve në Shtojcën e Vendimit (CFSP) 2025/1577 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

*Neni 1*

Shtojca e Vendimit (CFSP) 2025/1577 ndryshohet në përputhje me Shtojcën e këtij Vendimi.

*Neni 2*

Ky Vendim hyn në fuqi ditën pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Nënshkruar në Bruksel, më 19 shkurt 2026.

*Për Këshillin*

*President*

M. RAOUNA

---

(1) Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit 2001/931/CFSP i 27 dhjetorit 2001 mbi zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin (OJ L 344, 28.12.2001, f. 93, ELI: http://data.europa.eu/eli/compos/2001/931/oj).

(2) Vendimi i Këshillit (PPJS) 2025/1577 i datës 29 korrik 2025 për përditësimin e listës së personave, grupeve dhe subjekteve të mbuluara nga Qëndrimi i Përbashkët 2001/931/CFSP mbi zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin, dhe shfuqizimin e Vendimit (CFSP) 2025/207 (OJ L, 2025/1577, 30.7.2025, ELI: http://data.europa.eu/eli/dec/2025/1577/oj).

*SHTOJCA*

Në Shtojcën e Vendimit (CFSP) 2025/1577, nën titullin "II. Grupet dhe subjektet" shtohet njësia e mëposhtme: "23. "Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike (IRGC)".

Official Journal of the European Union
EN
L series
2026/421
19.2.2026

**COUNCIL DECISION (CFSP) 2026/421**

**of 19 February 2026**

**amending Decision (CFSP) 2025/1577 updating the list of persons, groups and entities covered by Common Position 2001/931/CFSP on the application of specific measures to combat terrorism**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 27 December 2001, the Council adopted Common Position 2001/931/CFSP [1].

(2) On 29 July 2025, the Council adopted Decision (CFSP) 2025/1577 [2]. That Decision establishes an updated list of persons, groups and entities to which the measures in Articles 2 and 3 of Common Position 2001/931/CFSP apply.

(3) The Council has determined that competent authorities within the meaning of Article 1(4) of Common Position 2001/931/CFSP have adopted decisions in respect of one entity involved in terrorist acts within the meaning of Article 1(3) of that Common Position, and that the measures in Articles 2 and 3 of that Common Position should be applied to that entity.

(4) The list of persons, groups and entities in the Annex to Decision (CFSP) 2025/1577 should be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

*Article 1*

The Annex to Decision (CFSP) 2025/1577 is amended in accordance with the Annex to this Decision.

*Article 2*

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 19 February 2026.

*For the Council*

*The President*

M. RAOUNA

---

(1) Council Common Position 2001/931/CFSP of 27 December 2001 on the application of specific measures to combat terrorism (OJ L 344, 28.12.2001, p. 93, ELI: http://data.europa.eu/eli/compos/2001/931/oj).

(2) Council Decision (CFSP) 2025/1577 of 29 July 2025 updating the list of persons, groups and entities covered by Common Position 2001/931/CFSP on the application of specific measures to combat terrorism, and repealing Decision (CFSP) 2025/207 (OJ L, 2025/1577, 30.7.2025, ELI: http://data.europa.eu/eli/dec/2025/1577/oj).

ANNEX

In the Annex to Decision (CFSP) 2025/1577, the following entity is added under the heading 'II. Groups and entities':

'23. "Islamic Revolutionary Guard Corps (IRGC)".'.

## VENDIM
## Nr. 219, datë 1.4.2026

## PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 684, DATË 23.10.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400 kV FIER'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 684, datë 23.10.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera "... prej 13 127 773 (trembëdhjetë milionë e njëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre) lekësh ..." zëvendësohet me "... 36 569 266 (tridhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë ...";

b) Tabela, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Për pasuritë me nr. 250/7, nr. 250/18, nr. 250/19, nr. 250/20, nr. 250/25, dhe nr. 250/80, që korrespondojnë me numrat rendorë 4, 14, 15, 16, 19 dhe 25, të tabelës bashkëlidhur vendimit në fuqi, pronarët e të cilave janë likuiduar sipas vlerës së përcaktuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, diferenca e vlerës së shtuar të kompensimit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, do t'i kalohet pronarëve të shpronësuar, të pasqyruar sipas numrave rendorë 4, 14, 15, 16, 19 dhe 25, të kësaj tabele.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400 kV FIER"

| Nr. | Të dhëna për pronësinë | | | | | Sip. që shpronësohet (m²) | Çmimi i tokës (lekë/m²) | Vlera e kulturave bujqësore (lekë) | Vlera e shpronësimit të tokës (lekë) | Vlera totale e shpronësimit (lekë) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emër Atësi Mbiemër | Lloji i pasurisë | ZK | Nr. pasurie | Sip. totale e pronës (m²) | | | | | | |
| Bashkia Fier/Fshati Drize | | Zona kadastrale nr. 1557 | | | | | | | | | |
| 1 | Shaban Sihat Gjeli | Arë | 1557 | 190/1 | 2,218 | 2,218 | 676 | 1,383 | 1,499,368.0 | **1,500,751** | |
| 2 | Iljaz Nurçe Shateri | Arë | 1557 | 192/1 | 878 | 878 | 676 | 547 | 593,528 | **594,075** | |
| 3 | Nuredin Iljas Shatëri | Arë | 1557 | 192/2 | 437 | 437 | 676 | 273 | 295,412 | **295,685** | |
| 4 | Fatmir Xhemil Brakaj<br>Tajane Jakup Brakaj | Arë | 1557 | 250/7 | 4,557 | 4,557 | 676 | 55,140 | 3,080,532 | **3,135,672** | |
| 5 | Ymer Dine Muhametaj<br>Florije Ymer Malaj<br>Vjollca Ymer Kodhelaj | Arë | 1557 | 250/95 | 3,777 | 3,777 | 676 | 897,635 | 2,553,252 | **3,450,887** | |
| 6 | Lavdosh Ismail Muhametaj<br>Afërdita Yemin Muhametaj<br>Riziana Lavdosh Muhametaj<br>Ismail Lavdosh Muhametaj<br>Muhamet Ismail Muhametaj<br>Drita Ismail Bogdani<br>Feruze Ismail Gjishti<br>Xixëllonja Ismail Xheka | Arë | 1557 | 250/82 | 2,827 | 2,827 | 676 | 14,619 | 1,911,052 | **1,925,671** | |
| 7 | Fetah Rapush Hoxha | Arë | 1557 | 250/10 | 2,312 | 2,312 | 676 | 1,491,707 | 1,562,912 | **3,054,619** | |
| 8 | Ali Kodhel Myrtaj | Arë | 1557 | 250/12 | 406 | 406 | 676 | 352,585 | 274,456 | **627,041** | |
| 9 | Zini Ali Myrtaj | Arë | 1557 | 250/13 | 2,093 | 2,093 | 676 | 3,064,780 | 1,414,868 | **4,479,648** | |
| 10 | Shpresa Rrapo Myrtaj | Arë | 1557 | 250/14 | 1,937 | 1,937 | 676 | 2,413,854 | 1,309,412 | **3,723,266** | |
| 11 | Xhevair Ali Myrtaj | Arë | 1557 | 250/15 | 1,625 | 1,625 | 676 | 2,413,854 | 1,098,500 | **3,512,354** | |
| 12 | Luan Hydai Gjata | Arë | 1557 | 250/16 | 562 | 562 | 676 | 339,549 | 379,912 | **719,461** | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | Agron Idai Gjata | Arë | 1557 | 250/17 | 875 | 875 | 676 | 339,549 | 591,500 | **931,049** | |
| 14 | Kostandin Vangjel Saramanda | Arë | 1557 | 250/18 | 1,078 | 1,078 | 676 | - | 728,728 | **728,728** | |
| 15 | Zoi Vangjel Saramanda | Arë | 1557 | 250/19 | 1,078 | 1,078 | 676 | - | 728,728 | **728,728** | |
| 16 | Bani Llazi Bare | Arë | 1557 | 250/20 | 1,000 | 1,000 | 676 | 624 | 676,000 | **676,624** | |
| 17 | Filip Tezho Baraj | Arë | 1557 | 250/22 | 1,000 | 1,000 | 676 | 624 | 676,000 | **676,624** | |
| 18 | Mihal Tezho Baraj<br>Lefteri Naun Baraj<br>Roland Mihal Baraj<br>Majlinda Idajet Baraj<br>Nikola Roland Baraj<br>Emiliano Roland Baraj<br>Mateo Roland Baraj | Arë | 1557 | 250/92 | 1,022 | 1,022 | 676 | 624 | 690,872 | **691,496** | |
| 19 | Nikollaq Todi Bare | Arë | 1557 | 250/25 | 1,776 | 1,776 | 676 | 1,107 | 1,200,576 | **1,201,683** | |
| 20 | Fetih Meto Gjata | Arë | 1557 | 250/26 | 974 | 974 | 676 | - | 658,424 | **658,424** | |
| 21 | Flutura Feti Avdulaj | Arë | 1557 | 250/27 | 187 | 187 | 676 | 117 | 126,412 | **126,529** | |
| 22 | Ismet Fetih Gjata | Arë | 1557 | 250/28 | 1,278 | 1,278 | 676 | 797 | 863,928 | **864,725** | |
| 23 | Ariste Naun Bare<br>Vladimir Mihal Bare<br>Aurel Mihal Bare<br>Katerina Jani Stavro<br>Aleksandra Aurel Bare | Arë | 1557 | 250/29 | 1,407 | 1,407 | 676 | 877 | 951,132 | **952,009** | |
| 24 | Artur Sotir Bare | Arë | 1557 | 250/30 | 898 | 898 | 676 | 10,866 | 607,048 | **617,914** | |
| 25 | Spiro Ndreu Bare | Arë | 1557 | 250/80 | 1,029 | 1,029 | 676 | - | 695,604 | **695,604** | |
| **“Ndërtimi i nënstacionit 400kV Fier” – Shuma e kompensimit (lekë)** | | | | | | | | **11,401,110** | **25,168,156** | **36,569,266** | |

**VENDIM**
**Nr. 220, datë 1.4.2026**

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PARKU NATYROR ‘LIQENI I ULZËS’ DHE ZONA E MBROJTUR PËRRETH TIJ”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË MAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Parku Natyror ‘Liqeni i Ulzës’ dhe zona e mbrojtur përreth tij”, me vendndodhje në Bashkinë Mat.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Mjedisit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall”, “njësi” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 4 041 111.70 (katër milionë e dyzet e një mijë e njëqind e njëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 041 111.70 (katër milionë e dyzet e një mijë e njëqind e njëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Ministria e Mjedisit.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Ministria e Mjedisit.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Mat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Ministrisë së Mjedisit për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Ministrisë së Mjedisit për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Mat, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit të Tokës pranë Këshillit të Qarkut Dibër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “PARKU NATYROR ‘LIQENI I ULZËS’ DHE ZONA E MBROJTUR PËRRETH TIJ”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË MAT

| Nr. | PRONARI | | | TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË) | | | | VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM | | | | | | | | | | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | TOKË TRUALL | | | TOKË ARË | | | NDËRTESË SOCIAL-EKONOMIKE | | | | |
| | Emri | Atësia | Mbiemri | ZK | Numri ipasurisë | Lloji Pasurisë | Sip. totale | Sipërfaqja e shpronësuar (m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera lekë | Sipërfaqja e shpronësuar (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera lekë | Sipërfaqja e shpronësuar | Vlera sipas preventivit | Vlerësimi i drufrutorëve | VLERA Totale (LEKË) | |
| 1 | Viktor | Dod | Lleshi | 2,198.00 | 181/1 | arë | 500.00 | | | | 500.00 | 114.00 | 57,000.00 | | | 508,938.00 | 565,938.00 | |
| 2 | Gjok<br>Gjele<br>Artan<br>Arta<br>Astrit<br>Alida | Zef<br>Mark<br>Gjok<br>Gjok<br>Gjok<br>Gjok | Stojani<br>Stojani<br>Stojani<br>Stojani<br>Stojani<br>Stojani | 2,198.00 | 183/1 | arë | 800.00 | | | | 800.00 | 114.00 | 91,200.00 | | | | 91,200.00 | |
| 3 | Liza | Gjon | Rica | 3,675.00 | 1/127/ND | ndërtesë | 110.00 | | | | | | | 110.00 | 1,507,360.40 | | 1,507,360.40 | |
| 4 | Adela | Ndue | Shpani | 3,675.00 | 1/16/ND1-N1 | njësi | 59.00 | | | | | | | 59.00 | 1,076,255.40 | | 1,076,255.40 | |
| 5 | Rudin | Gjon | Sefgjini | 3,675.00 | 1/16/ND1-N2 | njësi | 44.00 | | | | | | | 44.00 | 797,053.90 | | 797,053.90 | |
| 6 | Fran<br>Eduard<br>Bashkim<br>Teuta<br>Albert<br>Anisa | Pjetër<br>Fran<br>Fran<br>Fran<br>Fran<br>Fran | Nikolli<br>Nikolli<br>Nikolli<br>Nikolli<br>Nikolli<br>Nikolli | 3,675.00 | 1/70/1 | truall | 180.00 | 8.00 | 413.00 | 3,304.00 | | | | | | | 3,304.00 | |
| | | | | | | | | | | | | | | | **VLERA TOTALE** | | **4,041,111.70** | |

**VENDIM**
**Nr. 221, datë 1.4.2026**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “STUDIM, PROJEKTIM, AKSI RRUGOR ELBASAN–LEKAJ, KORRIDORI 8, LOTI I (FAZA I, II, III) ELBASAN–PAPËR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Studim, projektim, aksi rrugor Elbasan–Lekaj, korridori 8, loti I (faza I, II, III) Elbasan–Papër”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 46 241 507.4 (dyzet e gjashtë milionë e dyqind e dyzet e një mijë e pesëqind e shtatë pikë katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 46 241 507.4 (dyzet e gjashtë milionë e dyqind e dyzet e një mijë e pesëqind e shtatë pikë katër) lekësh

përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "STUDIM PROJEKTIM AKSI RRUGOR ELBASAN–LEKAJ KORRIDORI 8, LOTI I (FAZA I, II, III) ELBASAN–PAPËR"

| Nr. | Pronari | | | Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë) | | | | Vlerësimet për shpronësim sipas llojit | | | | | | | | | | Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqe totale | Shpronësimi tokë "arë" | | | Shpronësimi tokë "truall" | | | Shpronësimi ndërtesë banimi | | | Totali | |
| | | | | | | | | Sip. (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera (m²) | Sip. (m2) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera (m²) | Sip. (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera (m²) | | |
| 1 | MUSTAFA QAZIM DUJA | | | 1258 | 20/1/13 | Arë | 5000 | 677 | 222 | 150,294.0 | | | | | | | 150,294.0 | |
| 2 | DEMIR ISUF ÇELA | | | 3764 | 329/37 | Arë | 1044 | 43 | 222 | 9,546.0 | | | | | | | 9,546.0 | |
| 3 | ZYHDI QAZIM IBRO | | | 2876 | 139/5/1 | Arë | 3233 | 1311 | 222 | 291,042.0 | | | | | | | 291,042.0 | |
| 4 | PETREF REXHEP SENA | | | 2876 | 139/12/1 | Arë | 7000 | 1959 | 222 | 434,898.0 | | | | | | | 434,898.0 | |
| 5 | PETREF REXHEP SENA | | | 2876 | 139/55/1 | Arë | 3100 | 677 | 222 | 150,294.0 | | | | | | | 150,294.0 | |
| 6 | KUJTIM HAMIT SUBASHI | | | 2876 | 139/21/1 | Arë | 3721 | 797 | 222 | 176,934.0 | | | | | | | 176,934.0 | |
| 7 | ISAT HAZBI SUBASHI | | | 2876 | 139/23/1 | Arë | 833 | 190 | 222 | 42,180.0 | | | | | | | 42,180.0 | |
| 8 | SHYQYRI QAZIM SUBASHI | | | 2876 | 139/27/1 | Arë | 3438 | 793 | 222 | 176,046.0 | | | | | | | 176,046.0 | |
| 9 | ANILA AVNI XHAKOJ ELVIRA AVNI XHAKOJ | | | 2876 | 139/29/1 | Arë | 2599 | 394 | 222 | 87,468.0 | | | | | | | 87,468.0 | |
| 10 | QANI SELMAN KARAJ | | | 2876 | 139/31/1 | Arë | 1856 | 313 | 222 | 69,486.0 | | | | | | | 69,486.0 | |
| 11 | SHAQIR JONUZ DYBELI | | | 2876 | 139/9 | Arë | 3061 | 1132 | 222 | 251,304.0 | | | | | | | 251,304.0 | |
| 12 | SHAQIR JONUZ DYBELI | | | 2876 | 139/10 | Arë | 4256 | 1168 | 222 | 259,296.0 | | | | | | | 259,296.0 | |
| 13 | BAJRAM REXHEP BENA RAMIZ REXHEP BENA | | | 2876 | 139/15 | Arë | 6328 | 1645 | 222 | 365,190.0 | | | | | | | 365,190.0 | |
| 14 | HETEM RAMIS BENO | | | 2876 | 139/13 | Arë | 1898 | 495 | 222 | 109,890.0 | | | | | | | 109,890.0 | |
| 15 | NAZMI REXHEP BENA | | | 2876 | 139/14 | Arë | 2770 | 653 | 222 | 144,966.0 | | | | | | | 144,966.0 | |
| 16 | GANI HAMIT SUBASHI | | | 2876 | 139/20 | Arë | 7697 | 1549 | 222 | 343,878.0 | | | | | | | 343,878.0 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 17 | MEXHIT SUBASHI | 2876 | 139/22 | Arë | 3447 | 598 | 222 | 132,756.0 | | | | | | | 132,756.0 | |
| 18 | BASHKIM ELMAS SUBASHI | 2876 | 139/26 | Arë | 7808 | 1421 | 222 | 315,462.0 | | | | | | | 315,462.0 | |
| 19 | GANI RIZA KURTI | 2876 | 139/30 | Arë | 1246 | 220 | 222 | 48,840.0 | | | | | | | 48,840.0 | Në seksionin E të kartelës ka shënimin. Me shkresën nr. 1135 akti, dt. 12.02.2019, regjistrohet padia gjyq. Zamira Vyshka |
| 20 | KALEM RAKIP SUBASHI | 2876 | 139/32 | Arë | 1922 | 341 | 222 | 75,702.0 | | | | | | | 75,702.0 | |
| 21 | KADRI RAKIP SUBASHI | 2876 | 139/33 | Arë | 1928 | 418 | 222 | 92,796.0 | | | | | | | 92,796.0 | |
| 22 | XHEMAL QAZIM KARAJ | 2876 | 139/19 | Arë | 2760 | 579 | 222 | 128,538.0 | | | | | | | 128,538.0 | |
| 23 | BAJRAM QAZIM KARAJ | 2876 | 139/18 | Arë | 1326 | 495 | 222 | 109,890.0 | | | | | | | 109,890.0 | |
| 24 | MUHARREM QEMAL SUBASHI | 2876 | 139/3 | Arë | 510 | 471 | 222 | 104,562.0 | | | | | | | 104,562.0 | |
| 25 | HASAN BAJRAM HASALLA | 2876 | 139/6 | Arë | 2626 | 947 | 222 | 210,234.0 | | | | | | | 210,234.0 | |
| 26 | HASAN BAJRAM HASALLA | 2876 | 139/7 | Arë | 1290 | 455 | 222 | 101,010.0 | | | | | | | 101,010.0 | |
| 27 | HASAN BAJRAM ASALLA NEZIR HASAN ASALLA SHYQYRI HASAN ASALLA | 2876 | 139/8 | Arë | 8184 | 2644 | 222 | 586,968.0 | | | | | | | 586,968.0 | |
| 28 | HAMIT ABAZ ÇILI | 2876 | 139/53 | Arë | 9392 | 2262 | 222 | 502,164.0 | | | | | | | 502,164.0 | |
| 29 | KUJTIM HAMIT ÇILI | 2876 | 139/52 | Arë | 3522 | 1063 | 222 | 235,986.0 | | | | | | | 235,986.0 | |
| 30 | SEFER ALI HIMÇI | 2876 | 139/45 | Arë | 2348 | 562 | 222 | 124,764.0 | | | | | | | 124,764.0 | |
| 31 | SEFER ALI HIMÇI | 2876 | 139/46 | Arë | 540 | 435 | 222 | 96,570.0 | | | | | | | 96,570.0 | |
| 32 | NAZMI XHEVIT SKURA | 2876 | 139/50 | Arë | 4422 | 1169 | 222 | 259,518.0 | | | | | | | 259,518.0 | |
| 33 | RAMAZAN RESHIT SKURA | 2876 | 139/51 | Arë | 2000 | 1275 | 222 | 283,050.0 | | | | | | | 283,050.0 | |
| 34 | FADIL RESHIT SKURA | 2876 | 139/41 | Arë | 6349 | 1201 | 222 | 266,622.0 | | | | | | | 266,622.0 | |
| 35 | ISMAIL QAZIM KATESHI | 2876 | 139/44 | Arë | 5283 | 1149 | 222 | 255,078.0 | | | | | | | 255,078.0 | |
| 36 | HYSEN SEFER HIMÇI | 2876 | 139/48 | Arë | 4696 | 757 | 222 | 168,054.0 | | | | | | | 168,054.0 | |
| 37 | LIMAN ZENEL ÇELA | 2876 | 139/47 | Arë | 9618 | 1473 | 222 | 327,006.0 | | | | | | | 327,006.0 | |
| 38 | HAVA KATESHI | 2876 | 139/43 | Arë | 4120 | 846 | 222 | 187,812.0 | | | | | | | 187,812.0 | |
| 39 | KADRI QAZIM KATESHI | 2876 | 139/42 | Arë | 2931 | 910 | 222 | 202,020.0 | | | | | | | 202,020.0 | |
| 40 | ARIF JONUZ SUBASHI BUJAR ARIF SUBASHI | 2876 | 31/44 | Arë | 6761 | 2064 | 222 | 458,208.0 | | | | | | | 458,208.0 | |
| 41 | RAMAZAN ARIF SUBASHI | 2876 | 31/42 | Arë | 2557 | 988 | 222 | 219,336.0 | | | | | | | 219,336.0 | |
| 42 | BEQIR SHERIF DYBELI | 2876 | 31/38 | Arë | 4055 | 1404 | 222 | 311,688.0 | | | | | | | 311,688.0 | |
| 43 | ISMAIL IBRAHIM SENJA RYZHDI SENJA | 2876 | 31/39 | Arë | 5860 | 1375 | 222 | 305,250.0 | | | | | | | 305,250.0 | |
| 44 | PETRIT ISMAIL GJELI | 2876 | 31/37 | Arë | 4608 | 1420 | 222 | 315,240.0 | | | | | | | 315,240.0 | |
| 45 | RAMAZAN DEMIR KATESHI | 2876 | 31/36 | Arë | 7033 | 2106 | 222 | 467,532.0 | | | | | | | 467,532.0 | |
| 46 | FATMIR IBRAHIM BAJRAMI SERVETE TAHIR BAJRAMI | 2876 | 31/35 | Arë | 2670 | 887 | 222 | 196,914.0 | | | | | | | 196,914.0 | |
| 47 | ASAN HAXHI LATA | 2876 | 31/31 | Arë | 2032 | 582 | 222 | 129,204.0 | | | | | | | 129,204.0 | |
| 48 | EDUART HASAN LATA | 2876 | 31/32 | Arë | 1830 | 551 | 222 | 122,322.0 | | | | | | | 122,322.0 | |
| 49 | ALI MUSA SEJDINI | 2876 | 31/30 | Arë | 2575 | 832 | 222 | 184,704.0 | | | | | | | 184,704.0 | |
| 50 | MET MURAT KASA | 2876 | 31/27 | Arë | 3716 | 2812 | 222 | 624,264.0 | | | | | | | 624,264.0 | |
| 51 | RESHIT LIÇI | 2876 | 31/33 | Arë | 1800 | 578 | 222 | 128,316.0 | | | | | | | 128,316.0 | |
| 52 | LUTFI ISMAIL GJELI | 2876 | 31/34 | Arë | 3950 | 1194 | 222 | 265,068.0 | | | | | | | 265,068.0 | |
| 53 | ZYBER VELI SUBASHI | 2876 | 139/37 | Arë | 2256 | 245 | 222 | 54,390.0 | | | | | | | 54,390.0 | |
| 54 | ZYBER VELI SUBASHI | 2876 | 139/39 | Arë | 5720 | 774 | 222 | 171,828.0 | | | | | | | 171,828.0 | |
| 55 | ISUF HASAN KARAJ | 2876 | 52/1 | Arë | 4215 | 338 | 222 | 75,036.0 | | | | | | | 75,036.0 | |
| 56 | ISUF HASAN KARAJ | 2876 | 52/2 | Arë | 2934 | 532 | 222 | 118,104.0 | | | | | | | 118,104.0 | |
| 57 | NEZIR OSMAN KULLA | 2876 | 52/3 | Arë | 2467 | 618 | 222 | 137,196.0 | | | | | | | 137,196.0 | |
| 58 | MYZYR SKENDERI | 2876 | 52/5 | Arë | 2855 | 584 | 222 | 129,648.0 | | | | | | | 129,648.0 | |
| 59 | NDRIÇIM QERIM KARAJ | 2876 | 52/4 | Arë | 1970 | 629 | 222 | 139,638.0 | | | | | | | 139,638.0 | |
| 60 | XHEVAHIR ALI GJEVORI ISUF ALI GJEVORI | 2876 | 52/7 | Arë | 2070 | 178 | 222 | 39,516.0 | | | | | | | 39,516.0 | |
| 61 | HYDAJET SABRI CANI | 3702 | 1//1 | Arë | 1151 | 378 | 222 | 83,916.0 | | | | | | | 83,916.0 | |
| 62 | SABRI RAMAZAN CANI | 3702 | 1//2 | Arë | 1039 | 147 | 222 | 32,634.0 | | | | | | | 32,634.0 | |
| 63 | BEDRIJE OSMAN CANI<br>DONIKA DYLAVER ÇAUSHAJ<br>DYLAVER ARIF CANI<br>GËZIM DYLAVER CANI<br>JETMIRA DYLAVER PISHA<br>LINDITA DYLAVER PIRRA<br>SHPËTIM DYLAVER CANI<br>VALBONA DYLAVER HOXHA | 3702 | 1//4 | Arë | 3650 | 3381 | 222 | 750,582.0 | | | | | | | 750,582.0 | |
| 64 | XHEVIT RIZA CANI | 3702 | 1//5 | Arë | 1850 | 1404 | 222 | 311,688.0 | | | | | | | 311,688.0 | |
| 65 | KUJTIM RIZA CANI | 3702 | 1//6 | Arë | 2140 | 1261 | 222 | 279,942.0 | | | | | | | 279,942.0 | |
| 66 | LUZE MERSIN MEKSHI | 3702 | 18/2 | Arë | 1000 | 117 | 222 | 25,974.0 | | | | | | | 25,974.0 | |
| 67 | DALIP BAFTJAR BULLARI | 3702 | 18/6 | Arë | 1880 | 294 | 222 | 65,268.0 | | | | | | | 65,268.0 | |
| 68 | DALIP BAFTJAR BULLARI | 3702 | 20/15 | Arë | 1620 | 464 | 222 | 103,008.0 | | | | | | | 103,008.0 | |
| 69 | BAFTJAR ABAZ BULLARI | 3702 | 20/14 | Arë | 2500 | 530 | 222 | 117,660.0 | | | | | | | 117,660.0 | |
| 70 | SKENDER MUSA BULLARI | 3702 | 20/13 | Arë | 1636 | 527 | 222 | 116,994.0 | | | | | | | 116,994.0 | |
| 71 | MUSTAFA ABAS BULLARI<br>SAMI MUSTAFA BULLARI<br>SKËNDER MUSTAFA BULLARI | 3702 | 20/12 | Arë | 6050 | 1962 | 222 | 435,564.0 | | | | | | | 435,564.0 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | SHPETIME MUSTAFA BULLARI<br>LIRI KAMER BULLARI<br>FLUTURIM SAMI BULLARI<br>RUZHDIJE DALIP BULLARI<br>ALEKSANDËR SKËNDER BULLARI<br>LEONARD SAMI BULLARI | | | | | | | | | | | | | | | |
| 72 | SHEFQET GANI BULLARI<br>HANIFE RAMAZAN BULLARI<br>MANJOLA SHEFQET BULLARI<br>EDMIR SHEFQET BULLARI | 3702 | 20/10 | Arë | 3340 | 1121 | 222 | 248,862.0 | | | | | | | 248,862.0 | |
| 73 | SABIT GANI BULLARI | 3702 | 20/11 | Arë | 2850 | 694 | 222 | 154,068.0 | | | | | | | 154,068.0 | |
| 74 | ABEDIN MEHMET KOCIU | 3702 | 20/1 | Arë | 5700 | 3009 | 222 | 667,998.0 | | | | | | | 667,998.0 | |
| 75 | RUZHDI HYSEN BULLARI | 3702 | 20/2 | Arë | 6565 | 2294 | 222 | 509,268.0 | | | | | | | 509,268.0 | |
| 76 | ALI HYSEN BULLARI | 3702 | 20/3 | Arë | 4920 | 2495 | 222 | 553,890.0 | | | | | | | 553,890.0 | |
| 77 | ILJAS DALIP BULLARI<br>DRITA RIZA BULLARI<br>OLSI ILJAS BULLARI<br>ARANIT ILJAS BULLARI<br>HALIT DALIP BULLARI<br>FLAMUR DALIP BULLARI<br>RABIJE DALIP XHAKOJ<br>GUSHI DALIP BULLARI | 3702 | 20/7 | Arë | 4250 | 2325 | 222 | 516,150.0 | | | | | | | 516,150.0 | |
| 78 | VEIZ ABDYL META | 3702 | 20/5 | Arë | 4139 | 2001 | 222 | 444,222.0 | | | | | | | 444,222.0 | |
| 79 | PETRIT SHAHIN MEKSHI | 3702 | 18/3 | Arë | 1220 | 83 | 222 | 18,426.0 | | | | | | | 18,426.0 | |
| 80 | RESHIT MESUT CANI | 3702 | 18/8 | Arë | 1780 | 166 | 222 | 36,852.0 | | | | | | | 36,852.0 | |
| 81 | HALIT HASAN TUFA | 3702 | 18/10 | Arë | 3297 | 219 | 222 | 48,618.0 | | | | | | | 48,618.0 | |
| 82 | ISLAM HASAN BULLARI | 3702 | 18/11 | Arë | 6592 | 58 | 222 | 12,876.0 | | | | | | | 12,876.0 | |
| 83 | DERVISH RAMAZAN BULLARI<br>RAMIZ RAMAZAN BULLARI | 3702 | 18/9 | Arë | 4342 | 287 | 222 | 63,714.0 | | | | | | | 63,714.0 | |
| 84 | OSMAN XHEMAL CANI | 3702 | 20/17/1 | Arë | 6900 | 1598 | 222 | 354,756.0 | | | | | | | 354,756.0 | |
| 85 | XHEVDET ELMAN CANI | 3702 | 19/2 | Arë | 7342.3 | 3967 | 222 | 880,674.0 | | | | | | | 880,674.0 | |
| 86 | KUJTIM RIZA CANI | 3702 | 19/3 | Arë | 5710 | 3092 | 222 | 686,424.0 | | | | | | | 686,424.0 | |
| 87 | SHYQYRI ELMAZ CANI | 3702 | 19/4 | Arë | 2600 | 729 | 222 | 161,838.0 | | | | | | | 161,838.0 | |
| 88 | XHEVIT RIZA CANI | 3702 | 19/5 | Arë | 7376 | 3250 | 222 | 721,500.0 | | | | | | | 721,500.0 | |
| 89 | BASHKIM REXHEP LIÇI | 3702 | 19/6 | Arë | 6761 | 2867 | 222 | 636,474.0 | | | | | | | 636,474.0 | |
| 90 | DYLAVER ARIF CANI<br>BEDRIJE OSMAN CANI<br>JETMIRA DYLAVER CANI<br>VALBONA DYLAVER CANI<br>LINDITA DYLAVER CANI<br>GËZIM DYLAVER CANI<br>SHPËTIM DYLAVER CANI<br>DONIKA DYLAVER CANI<br>NIGJARE ARIF ZEKTHI<br>SHAHE ARIF LIÇI<br>DUDI ARIF KRECI<br>HYSMETE ARIF KURTI<br>LUMTURI ARIF LEKTHI | 3702 | 19/7 | Arë | 9020 | 574 | 222 | 127,428.0 | | | | | | | 127,428.0 | |
| 91 | SABRI RAMAZAN CANI | 3702 | 19/9 | Arë | 3660 | 1508 | 222 | 334,776.0 | | | | | | | 334,776.0 | |
| 92 | RAMAZAN RAMAZAN CANI | 3702 | 19/8 | Arë | 6530 | 3961 | 222 | 879,342.0 | | | | | | | 879,342.0 | |
| 93 | RESHAT SABRI CANI<br>EMIN SABRI CANI | 3702 | 19/10 | Arë | 6390 | 1504 | 222 | 333,888.0 | | | | | | | 333,888.0 | |
| 94 | HYDAJET SABRI CANI | 3702 | 19/11 | Arë | 3200 | 1661 | 222 | 368,742.0 | | | | | | | 368,742.0 | |
| 95 | SHKELQIM PETRIT CANI | 3702 | 19/12 | Arë | 4470 | 1871 | 222 | 415,362.0 | | | | | | | 415,362.0 | |
| 96 | BASHKIM REXHEP LIÇI | 3702 | 4//12 | Arë | 2286 | 158 | 222 | 35,076.0 | | | | | | | 35,076.0 | |
| 97 | SABRI RAMAZAN CANI | 3702 | 4//13 | Arë | 1000 | 324 | 222 | 71,928.0 | | | | | | | 71,928.0 | |
| 98 | JEMIN SABRI CANI | 3702 | 4//14 | Arë | 1840 | 716 | 222 | 158,952.0 | | | | | | | 158,952.0 | |
| 99 | HANÇE MISIR CANI<br>SHKELQIM PETRIT CANI<br>ADRIANA PETRIT (CANI) ZOGU<br>BLERTA PETRIT TABAKU (CANI)<br>MANUSHAQE PETRIT LLESHI<br>(CANI) XHEMILE HASAN CANI<br>JONIDA SHKELQIM CANI<br>ADRIATIK SHKELQIM CANI<br>ARJAN PETRIT CANI<br>FATMIRE PETRIT CANI | 3702 | 4//15 | Arë | 3920 | 59 | 222 | 13,098.0 | | | | | | | 13,098.0 | |
| 100 | SARE SEIT KULLOLLI<br>YMER IBRAHIM KULLOLLI | 1085 | 21/7 | Arë | 1800 | 1074 | 222 | 238,428.0 | | | | | | | 238,428.0 | E-Informacione të tjera mbi pronën: “Kanali i ujit të zi 306” |
| 101 | ALBAN HAZIZ DURAKU<br>ANA HAZIZ DURAKU<br>FATIME MUSA DURAKU<br>HAZIZ HAMIT DURAKU<br>NEXHMIJE SHERIF DURAKU | 1085 | 21/5 | Arë | 2800 | 1484 | 222 | 329,448.0 | | | | | | | 329,448.0 | E-Informacione të tjera mbi pronën: “Kanali i ujit të zi 257” |
| 102 | HAVA SHAHIN DURAKU<br>RAMAZAN HAZIS DURAKU | 1085 | 21/3 | Arë | 3600 | 2357 | 222 | 523,254.0 | | | | | | | 523,254.0 | E-Informacione të tjera mbi pronën: “Kanali i ujit të zi 265” |
| 103 | BARDHYL IMER TEODORI<br>IMER HAXHI TEODORI<br>MITE IMER TEODORI | 1085 | 17/10 | Arë | 2000 | 1651 | 222 | 366,522.0 | | | | | | | 366,522.0 | E-Informacione të tjera mbi pronën: |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | MYRVET IMER TEODORI<br>SHADIJE TAIP TEODORI<br>TUFIJE IMER TEODORI<br>VLADIMIR IMER TEODORI | | | | | | | | | | | | | | | "Kanali i ujit të zi 433" |
| 104 | ALMA SERVET QEVANI<br>ARDJAN SERVET QEVANI<br>DHURATA SERVET QEVANI<br>FERDINAND SERVET QEVANI<br>MEREME SEFRET QEVANI<br>SERVET SHABAN QEVANI | 1085 | 17/4 | Arë | 5300 | 987 | 222 | 219,114.0 | | | | | | | 219,114.0 | E-Informacione të tjera mbi pronën: Ish Rep. Ushtarak 397 |
| 105 | ALTIN SABRI QEVANI<br>BEDRIJE YMER QEVANI<br>MATILDA SABRI QEVANI<br>SABRI SHABAN QEVANI | 1085 | 17/6 | Arë | 2400 | 838 | 222 | 186,036.0 | | | | | | | 186,036.0 | E-Informacione të tjera mbi pronën: Ish Rep. Ushtarak 430 |
| 106 | FADIL SHABAN QEVANI<br>KLEVIS FADIL QEVANI<br>LEJLA HASAN QEVANI | 1085 | 17/8 | Arë | 2300 | 893 | 222 | 198,246.0 | | | | | | | 198,246.0 | E-Informacione të tjera mbi pronën: Rep. Ushtarak 250 |
| 107 | BRUNILDA MEVLAN KASA<br>ELIDA MEVLAN KASA<br>KLEMENT MEVLAN KASA<br>LORETA MEVLAN KASA<br>OLTJON MEVLAN KASA<br>RUDINA MEVLAN KASA<br>SHPRESA MUSTAFA KASA<br>MEVLAN ALI KASA | 1085 | 19/21 | Arë | 7300 | 1115 | 222 | 247,530.0 | | | | | | | 247,530.0 | E-Informacione të tjera mbi pronën: Gropa Siliazhi 245 |
| 108 | ASTRIT YMER KULLOLLI<br>ERSIDA ASTRIT KULLOLLI<br>ERVIN ASTRIT KULLOLLI<br>VALENTINA NESHDET KULLOLLI | 1085 | 21/10 | Arë | 3000 | 1936 | 222 | 429,792.0 | | | | | | | 429,792.0 | E-Informacione të tjera mbi pronën: Kanali i ujit të zi 217 |
| 109 | ARBEN DERVISH KULLOLLI<br>DERVISH YMER KULLOLLI<br>FIZE ALI KULLOLLI<br>FJORENTINA DERVISH KULLOLLI<br>MARJO DERVISH KULLOLLI | 1085 | 21/12 | Arë | 2500 | 1017 | 222 | 225,774.0 | | | | | | | 225,774.0 | E-Informacione të tjera mbi pronën: Kanali i ujit të zi 302 |
| 110 | RIFAT HAMIT DURAKU | 1085 | 21/14 | Arë | 2200 | 413 | 222 | 91,686.0 | | | | | | | 91,686.0 | |
| 111 | DASHAMIR QEMAL MOLI | 1258 | 20/1/11-ND | Ndërtesë | | | | | | | | 66.7 | 32695 | 2180756.5 | 2,180,756.5 | |
| 112 | DASHAMIR QEMAL MOLI | 1258 | 20/1/54 | Truall | 200.1 | | | | 200.1 | 1840 | 368184 | | | | 368,184.0 | |
| 113 | EN-SAL | 3764 | 52/26/6 | Truall | 380.1 | | | | 380.1 | 284 | 107948.4 | 135.8 | 32695 | 4439981 | 4,547,929.4 | |
| 114 | GENCI CANI<br>NERTILA CANI | 3702 | 1/5/1-ND | Ndërtesë | | | | | | | | 271.8 | 32695 | 8886501 | 8,886,501.0 | |
| 115 | HIQMET HYSEN LENA | 3965 | 597/2-ND | Ndërtesë | | | | | | | | 90.3 | 32695 | 2952358.5 | 2,952,358.5 | |
| Vlera totale | | | | | | | | | | | | | | | 46,241,507.4 | |

**VENDIM**
**Nr. 222, datë 1.4.2026**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION, RRUGA 'MARIN BEÇIKEMI', BASHKIA SHKODËR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Rikonstruksion, rruga 'Marin Beçikemi', Bashkia Shkodër".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

3. Pronari i pasurisë të paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 859 611 (tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 859 611 (tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Shkodër.

8. Bashkia Shkodër kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Shkodër.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Shkodër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION RRUGA 'MARIN BEÇIKEMI'"

| Nr. | Pronari | | | Të dhëna kadastrale (sipas kartelës së pasurisë) | | | | | | | | | Vlerësimet për shpronësim | | | | | | | Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | Truall | | | Ndërtesë banimi | | | Vlera totale (lekë) | |
| | Emri | Atësia | Mbiemri | Qyteti | Zona kadastrale | Indeksi i hartës | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sip. totale (m²) | Truall (m²) | Volumi | Faqe | Sip. (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera (lekë) | Sip. (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera (lekë) | | |
| 1 | FRANÇESKO | | GJELOSHI | Shkodër | 8593 | M-9 | 4/343 | TRUALL | 101 | 101 | 23 | 119 | 101 | 8511 | 859,611 | 56 | | - | 859,611 | Objekt i shembur. |
| Vlera totale | | | | | | | | | | | | | | | | | | | **859,611** | |

**VENDIM**
**Nr. 225, datë 1.4.2026**

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË PËRFITIMIT, KRITEREVE DHE KUSHTEVE TË VEÇANTA TË PËRFITIMIT PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME, PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022, "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e masës së përfitimit, kritereve dhe kushteve e veçanta të përfitimit të fondit për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), të cilat synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, inovacionin dhe rinovimin e teknologjisë, me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve, lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm.

2. Termat e përdorur në përmbajtje të këtij vendimi kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në pikat 4 dhe 5, të nenit 3, të ligjit nr. 43/2022, "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme".

3. Nuk përfitojnë nga ky fond ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat kanë përfituar burime financimi nga donatorë apo nga institucione financiare kombëtare dhe ndërkombëtare për të njëjtët zëra apo aktivitete të lejuara nga këto projekte.

II. MASA E PËRFITIMIT, KRITERET DHE KUSHTET E VEÇANTA PËR PËRFITIMIN E FONDIT

1. Skema e mbështetjes financiare për shpenzimet korrente të programit ekonomik (04130) "Mbështetje për zhvillimin ekonomik" të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit është në vlerën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, që mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesë qind mijë) lekë.

2. Aplikuesit për përfitimin e fondit plotësojnë kriteret e përgjithshme, të përcaktuara në pikën 5, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022, "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme", si dhe kriteret e veçanta të lidhura me projektplanin e biznesit, si më poshtë vijon:

a) Përputhshmëria e planit të biznesit me objektin dhe qëllimet e dhënies së fondit, duke pasur në fokus nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm;

b) Plani i biznesit, i detajuar me objektiva dhe elemente, të cilat identifikohen nëpërmjet rezultateve të matshme nga realizimi i tij;

c) Përshkrimi i detajuar i aktiviteteve që do realizohen;

ç) Përshkrimi i impaktit dhe i rezultateve të matshme;

d) Të dhëna konkrete që aktivitetet e ndërmarrjes rrisin numrin e të punësuarve;

dh) Të dhëna konkrete dhe të argumentuara për impaktin pozitiv mjedisor.

3. Aktivitetet e lejuara, me qëllim përfitimin e fondit, janë skema të mbështetjes financiare për zërin "Shpenzimet korrente", që mbulon kostot e mëposhtme:

a) Certifikim të standardeve të prodhimit/shërbimit (përfshirë konsulencën përkatëse në fazën përgatitore);

b) Përmirësim të produktit përmes ambalazhimit, etiketimit;

c) Trajnime të stafit të ndërmarrjes për rritje kapacitetesh në fusha të tilla si: menaxhimi i teknologjive digjitale/inovatore, rrjetet e prokurimit, shërbime marketingu, zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës së biznesit, sisteme të reja logjistike *software* apo pajisje të reja etj., dhe pajisje me certifikatat përkatëse nga subjekte të licencuara për trajnime;

ç) Krijimi i aplikacioneve apo i platformave, në funksion të zhvillimit të proceseve, lidhur me tregtinë elektronike/*e-Commerce,* produkteve të reja dhe/ose shërbimeve, për të përmbushur kërkesat e industrisë së tregut në vend dhe rajon për të përmirësuar biznesin, sistemet logjistike etj.

4. Dokumentacioni i nevojshëm, që shoqëron kërkesën për aplikim, duhet të dorëzohet i firmosur dhe i vulosur nga aplikuesi, në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin, e të lëshuara jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë nga data e aplikimit për fonde.

5. Disbursimi i fondit do të bëhet me dy këste, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 539, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, funksionimin, shpërblimin e anëtarëve të bordit vlerësues të kërkesave, si dhe procedurën konkurruese për dhënien e granteve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme", të ndryshuar.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 227, datë 1.4.2026**

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 707, DATË 21.11.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR TURIZMIN TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË VIJËN BREGDETARE SHKODËR–FIER", TË NDRYSHUAR, DHE PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SPORTIN DHE TURIZMIN TË PASURISË NR. 284/5, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 3774, RROGOZHINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shtojcën e vendimit nr. 707, datë 21.11.2018, të Këshillit të Ministrave, në pikën 20 hiqet prona e paluajtshme me nr. 284/5, me vendndodhje në zonën kadastrale 3774.
2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për sportin dhe turizmin të pronës së paluajtshme shtetërore, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme dhe fragmentit të hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
3. Ngarkohen ministria përgjegjëse për sportin dhe turizmin dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

**KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME**

Kodi Unik 3774013025
(Nga ____ , Në ____)

**A - TË DHËNAT E PASURISË**

Zona Kadastrale Nr. 3774 , Lloji i Pasurisë: RANISHTE , Nr. i Pasurisë: 284/5 , Sipërfaqja Totale 294845 m2, (Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-100-(223-B-C-D), Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia VILE BALLAJ , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. ___ , SH/K ___ , Apartamenti Nr. ___
Vlera e Pasurisë:
Fillestare __ (Akti Nr. __ , Dt. ____), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

**B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË**

Pronari: REP. E SHQIPERISE NE PERGJEGJESI ADMINISTRIMI TE MINISTRISE PERGJEGJESE PER TURIZMIN, Nr. Identifikimi/NIPT SG3798556813, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia TIRANE , Rruga ____ , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. 00001935, Datë: 19/03/2019

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

**B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK**

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

## KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

### C-TË DREJTAT REALE

| Nr. Regjistrimi | Dt. Regjistrimi | Lloji i të Drejtës | Të Dhënat e Aktit | | | Afati i Vlefshmërisë | Përfitues | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Emërtim | Nr. | Datë | | Emër Atësi Mbiemër | Nr. Identifikimi/ NIPT |
| | | | | | | | | |

### D - KUFIZIMET E PRONËSISË

| Nr. Regjistrimi | Dt. Regjistrimi | Lloji i Kufizimit | Të Dhënat e Aktit | | | Afati i Kufizimit | Përfitues/Kërkues | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Emërtim | Nr. | Datë | | Emër Atësi Mbiemër | Nr. Identifikimi/ NIPT |
| | | | | | | | | |

### E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi:

**DREJTORI**
Elvis Pengili

Grenald Leka — Digitally signed by: Grenald Leka Date: 2026.01.08 04:22:43 +02'00'

Hysni Velja — Digitally signed by: Hysni Velja Date: 2026.01.08 04:52:41 +02'00'

Data e lëshimit 08/01/2026

Elvis Pengili — Digitally signed by: Elvis Pengili Date: 2026.01.08 04:55:20 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore DURRËS-KAVAJË-KRUJË
Date:2026/01/08 16:22:41 +02'00'
J91326001G20260108162234 36ASHK

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)*

2/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

## FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

| | |
|---|---|
| ZONA KADASTRALE: 3774 | KODI UNIK: 3774013025 |
| NUMRI PASURISË : 284/5 | INDEX I HARTËS: K-34-99-223-B |

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE




SH 1:5000

DREJTORI
Elvis Pengili

Data e lëshimit: 08/01/2026
Vendore DURRËS-KAVAJË-KRUJË
Date:2026/01/08 16:54:43 +02'00'
J91326001G20260108165434950 14

**SHPJEGUES**
- PARCELA
- NDERTESA

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore DURRËS-KAVAJË-KRUJË)*

**VENDIM**
**Nr. 229, datë 1.4.2026**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 486, DATË 17.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHTYPJEN, BOTIMIN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19 e 47, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja "a", e pikës 6, të vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Nxënësit, që ndjekin arsimin bazë, nga klasa e parë deri në klasën e pestë, në institucionet arsimore publike, në institucionet e paraburgimit, të vuajtjes së dënimit dhe në institucionet e përkujdesjes shoqërore, të cilëve u jepen tekstet shkollore të reja, çdo vit, në përdorim falas. Nxënësve, që ndjekin arsimin bazë në këto institucione, nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë, u jepen tekstet shkollore në përdorim falas.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 230, datë 1.4.2026**

**PËR PËRCAKTIMIN E MODELIT TË FINANCIMIT TË BUXHETIT PËR SHKENCËN DHE KËRKIMIN SHKENCOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 109/2024, "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të financimit të buxhetit për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë, me qëllim krijimin e një sistemi të qëndrueshëm, transparent dhe të matshëm të financimit të kërkimit shkencor, i cili zbatohet për të gjitha institutet dhe njësitë e veçanta publike kërkimore, në varësi të ministrive dhe institucioneve qendrore të administratës shtetërore.

2. Modeli i financimit të kërkimit shkencor përbëhet nga këto instrumente:

a) Financimi bazë institucional (FBI);

b) Financimi i orientuar nga performanca (FOP);

c) Financimi për projekte kërkimore konkurruese (FPK), pjesë e të cilit është edhe fondi për infrastrukturën kërkimore dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor.

3. Financimi bazë institucional (FBI) dhe financimi i orientuar nga performanca (FOP) sigurohen me fonde të buxhetit të shtetit, që shpërndahen nëpërmjet buxheteve të ministrive, apo të institucioneve qendrore përkatëse, që kanë propozuar krijimin e tyre.

4. Fondi për projektet kërkimore konkurruese (FPK) sigurohet me fonde të buxhetit të shtetit, i cili administrohet dhe shpërndahet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (në vijim "AKKSHI").

5. AKKSHI-ja ushtron funksionet e vlerësimit teknik, verifikimit të të dhënave, llogaritjes vjetore të koeficientëve $K_1$, $K_2$, $K_3$ dhe $K_4$ dhe të indeksit të performancës (IP), si dhe publikon çdo vit tabelën zyrtare përkatëse për financimin e orientuar nga performanca (FOP), sipas përcaktimeve në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Financimi bazë institucional (FBI):
a) përbën instrumentin kryesor të financimit publik për institutet dhe njësitë e veçanta publike kërkimore;
b) ka për qëllim garantimin e funksionimit minimal dhe të qëndrueshëm të tyre;
c) garanton mbulimin e detyrimeve për paga, kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe shpenzimet e funksionimit të tyre, bazuar në strukturën organike të miratuar dhe kostos për funksionimin minimal;
ç) planifikohet dhe shpërndahet nga institucionet krijuese të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor.
7. Financimi i orientuar nga performanca (FOP):
a) është një instrument financiar shtesë, i cili synon të stimulojë rritjen e cilësisë, produktivitetit dhe ndikimit të veprimtarisë kërkimore të instituteve dhe njësive të veçanta publike kërkimore;
b) bazohet në indeksin e performancës (IP), që është treguesi i përbërë sasior, i llogaritur nga AKKSHI-ja, sipas metodologjisë së përcaktuar në aneksin 1, i cili pasqyron në mënyrë krahasuese performancën e instituteve dhe njësive të veçanta publike kërkimore dhe shërben si bazë për shpërndarjen e financimit të orientuar nga performanca (FOP);
c) shpërndahet 100% proporcionalisht me indeksin e performancës (IP) mbi bazën e koeficientëve $K_1$–$K_4$, të llogaritur nga AKKSHI-ja, sipas formulës:
$IP_i = 0.4K_{1i} + 0.3K_{2i} + 0.2K_{3i} + 0.1K_{4i}$;
$FOP_i = FOP_total \times IP_i / \Sigma IP$.
Në aneksin 1 jepet shembull ilustrues për llogaritjen e tij.
8. Pragu minimal i indeksit të performancës (IP) përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për shkencën. Institucionet me indeks performance (IP) nën pragun e përcaktuar me udhëzim nuk përfitojnë FOP-in për atë vit. Nëse IP-ja i një institucioni bie më shumë se 20% krahasuar me vitin pararendës, pjesa e FOP-it për atë institucion ulet në mënyrë proporcionale me normën e rënies.
9. Në rast se në një institucion krijues ka vetëm një institucion ose njësi të veçantë kërkimore, financimi i orientuar nga performanca (FOP) aplikohet mbi bazën e vlerësimit të arritjes së objektivave të përcaktuar në kontratën e performancës dhe treguesve të miratuar paraprakisht.
10. Financimi i orientuar nga performanca (FOP) për institutet dhe njësitë e veçanta publike kërkimore aplikohet vitin e katërt, nga viti i krijimit ose i riorganizimit të tyre, pas përfundimit të një periudhe fillestare 3-vjeçare konsolidimi dhe ndërtimi kapacitetesh.
11. Gjatë periudhës së parë 3-vjeçare nga krijimi ose riorganizimi këto institucione financohen vetëm nëpërmjet financimit bazë institucional (FBI) dhe, kur është e zbatueshme, nëpërmjet financimit konkurrues për projekte (PK).
12. Financimi konkurrues për projekte (PK) është një instrument financiar që përdoret për mbështetjen e projekteve mbi bazë thirrjesh të hapura dhe procedurash konkurruese.
13. Institucionet e arsimit të lartë, institucionet e krijuara me ligj të posaçëm, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor financohen nga fondi i programeve konkurruese, në bazë të projekteve konkurruese në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor. Përzgjedhja dhe vlerësimi i projekteve konkurruese bëhet sipas procedurave dhe kritereve të vlerësimit, të përcaktuara në udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për çështjet e shkencës dhe kërkimin shkencor, sipas një metodologjie të publikuar paraprakisht.
14. Financimi për zhvillimin e kapitalit njerëzor kërkimor përfshin mobilitetin shkencor, formimin e avancuar, shkëmbimet ndërkombëtare dhe trajnimin në standardet e zonës evropiane të kërkimit (ERA), me synim forcimin e kapaciteteve të kërkuesve dhe integrimin e tyre në rrjetet ndërkombëtare.
15. Projektet kërkimore mund të bashkëfinancohen nga buxheti i shtetit, donatorë kombëtarë ose ndërkombëtarë dhe entitete private, vendëse ose të huaja. Bashkëfinancimi formalizohet përmes një marrëveshjeje të posaçme, e cila përcakton:
a) instrumentet financiare të përdorura;
b) përqindjen e kontributeve të secilës palë;
c) kategoritë e shpenzimeve të pranueshme;
ç) procedurat e auditimit dhe kontrollit.
16. Pragu minimal i bashkëfinancimit të kërkuar duhet të jetë i përcaktuar në shpalljen e thirrjes nga AKKSHI-ja, përpara aplikimit nga subjektet. Mosrespektimi i marrëveshjes së bashkëfinancimit përbën shkak për ndërprerjen e financimit dhe kthimin e fondeve.

17. Institucionet përfituese dorëzojnë raporte teknike dhe financiare, sipas formateve të standardizuara, të miratuara nga AKKSHI-ja dhe në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Monitorimi kryhet përmes vizitave në terren, verifikimit të planit të punës, analizës së treguesve të performancës dhe mekanizmave të monitorimit. Në rastet kur objektivat nuk realizohen, zbatohen masa, si reduktimi i fondeve, riorientimi i burimeve ose penalitete të tjera, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kontrollin dhe menaxhimin financiar.

18. Në rast të pjesëmarrjes së shtetit shqiptar në një konsorcium evropian të infrastrukturës së kërkimit (ERIC), financimi i këtij konsorciumi duhet të plotësojë të gjitha kërkesat, modalitetet dhe procedurat e përcaktuara në rregulloren mbi kuadrin ligjor të komunitetit për një konsorcium evropian të infrastrukturës kërkimore (ERIC) nr. 723/2009, datë 25 qershor 2009, të ndryshuar, dhe zbatohen rregullat e përcaktuara në këto rregullore.

19. Dispozitat e shkronjave "a" dhe "b", të pikës 2, të këtij vendimi, nuk zbatohen për institucionet e krijuara me ligje të posaçme.

20. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe kërkimit shkencor, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet, institutet dhe njësitë e veçanta, që ushtrojnë veprimtari në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**ANEKSI 1**

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË KOEFICIENTËVE $K_1$, $K_2$, $K_3$ DHE $K_4$ PËR LLOGARITJEN E FINANCIMIT TË ORIENTUAR NGA PERFORMANCA

Ky aneks përcakton metodologjinë e vlerësimit dhe llogaritjes së koeficientëve $K_1$–$K_4$.

Vlerësimi kryhet nga AKKSHI mbi bazën e të dhënave të verifikueshme për periudhën 3-vjeçare të fundit.

Të gjithë treguesit normalizohen në intervalin [0–1] dhe përdoren në mënyrë krahasuese.

$K_1$ – **Performanca shkencore (40%)**: mat prodhimin shkencor (publikime të indeksuara, citime, monografi, projekte ndërkombëtare, patenta).

$K_2$ – **Kapacitetet njerëzore kërkimore (30%)**: mat nivelin dhe cilësinë e stafit (doktorë, tituj, kërkues të rinj, rrjete ndërkombëtare).

$K_3$ – **Aftësia për tërheqje fondesh konkurruese (20%)**: mat vlerën dhe numrin e projekteve konkurruese të fituara.

$K_4$ – **Ndikimi institucional dhe shoqëror (10%)**: mat përdorimin e rezultateve në politika publike, kontrata shërbimesh dhe transferim teknologjie.

Për secilin koeficient **$K_1$, $K_2$, $K_3$ dhe $K_4$**, vlera maksimale **1 (një)** i jepet institucionit që, për periudhën e referencës 3-vjeçare, paraqet **vlerën më të lartë absolute të treguesit përkatës**, sipas të dhënave të verifikuara nga AKKSHI-ja.

Vlerat e institucioneve të tjera për secilin koeficient llogariten në % në mënyrë proporcionale, sipas formulës:

**$K_i$ (institucion) = $V_i$ (institucion)/$V_i$ (max)**

ku:

- **$V_i$ (institucion)** është vlera faktike e treguesit përkatës për institucionin;

- **$V_i$ (max)** është vlera më e lartë e konstatuar ndërmjet të gjitha institucioneve për të njëjtin tregues.

AKKSHI-ja dokumenton burimet e të dhënave dhe publikon tabelën përfundimtare vjetore.

Shembull ilustrues për llogaritjen e **indeksit të performancës (IP)**

Supozohet një ministri që ka në varësi 2 (dy) institute publike kërkimore. Fondi total për financimin e orientuar nga performanca (FOP) është 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

**Koeficientet e performancës (shembull ilustrues)**

| **Instituti** | **$K_1$** | **$K_2$** | **$K_3$** | **$K_4$** |
|---|---|---|---|---|
| A | 1.00 | 0.90 | 0.80 | 0.70 |
| B | 0.60 | 0.70 | 0.40 | 0.50 |

Sipas formulës $IP_i = 0.4K_{1i} + 0.3K_{2i} + 0.2K_{3i} + 0.1K_{4i}$; rezulton: IP(A) = 0.90; IP(B) = 0.58;

IP_total = (0.90+0.58) = 1.48.

V(A) në % = 0.90/1.48 = 60,8%

V(B)= 0,58/1.48= 39,2%.

**Shpërndarja e financimit të orientuar nga performanca (FOP)**

FOP shpërndahet 100%, sipas performancës:

A = 60.8% (12 160 000 lekë);

B = 39.2% (7 840 000 lekë).

**VENDIM**
**Nr. 231, datë 1.4.2026**

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMAVE TË MBËSHTETJES NËPËRMJET SUBVENCIONIT PËR NDËRMARRJET SOCIALE, PËR PERIUDHËN 2026–2028**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale, të njohura si të tilla nga ministri përgjegjës për çështjet sociale, me vlerë të përgjithshme 210 000 000 (dyqind e dhjetë milionë) lekë, për periudhën 2026–2028, sipas produktit përkatës të parashikuar në programin buxhetor afatmesëm "Përkujdesja sociale".

2. Format e mbështetjes së ndërmarrjeve sociale nëpërmjet subvencionit janë:

a) mbështetja e hapjeve të vendeve të reja të punës në pagesën e pagës minimale të punonjësve të ndërmarrjeve sociale, që i përkasin grupeve të pafavorizuara;

b) mbështetja në pagesën e sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të ndërmarrjeve sociale, që i përkasin grupeve të pafavorizuara.

3. Ndërmarrjet sociale, që përfitojnë subvencione për krijimin e vendeve të reja të punës, duhet të kenë:

a) një projektpropozim 3-vjeçar;

b) dokument që vërteton rritjen e numrit të të punësuarve, me përfaqësues nga grupet e pafavorizuara, të evidentuar në programet e mbrojtjes sociale dhe të punësimit, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kërkesa me shkrim shoqërohet dhe me dokumentacione të tjera shtesë, si më poshtë vijon:

a) Ekstraktin historik të kompanisë, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

b) Kopje të pasqyrave financiare të vitit paraardhës në rast se organizata e ushtron aktivitetin prej më shumë se një viti dhe formularët e deklarimeve e të pagesave për personat fizikë;

c) Vërtetimin nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për aq kohë sa ushtron veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare nga çasti i aplikimit;

ç) Informacionin mbi numrin e të punësuarve dhe nivelin e pagës së dhënë për çdo person;

d) Vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesit, të specifikuar për tre muajt e fundit;

dh) Një kopje të aktit të inspektimit në punë në rast se organizata ka ushtruar më parë aktivitetin e saj.

5. Një ndërmarrje sociale mund të përfitojë subvencion për hapjen e deri 10 (dhjetë) vendeve të reja të punës, ku përfshihen pagesat e pagës minimale për punëmarrësit, për një periudhë 3-vjeçare.

6. Financimi i dy formave të subvencioneve, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, të pagës minimale dhe të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të punëdhënësit dhe punëmarrësit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, bëhet në masën 100%, kundrejt paraqitjes së listëpagesave të punonjësve pranë Shërbimit Social Shtetëror.

7. Ndërmarrjet sociale, që paraqesin kërkesë për mbështetjen nga format e subvencioneve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, duhet të plotësojnë këto kushte:

a) Nuk duhet të kenë shkelur legjislacionin e punës dhe atë tatimor, lidhur me detyrimet ndaj punëmarrësve;

b) Kohëzgjatja e kontratës për të punësuarit nga kategoritë e grupeve të pafavorizuara të jetë jo më pak se 3 (tre) vjet, duke garantuar qëndrueshmëri në vitet në vijim.

c) Jo më pak se 30% e të punësuarve të jenë pjesë e programeve të mbrojtjes sociale.

8. Subvencionimi i ndërmarrjeve sociale në një nga format e përcaktuara në këtë vendim nuk kushtëzon të drejtën e tyre për të përfituar nga forma të tjera të mbështetjes së ndihmës shtetërore, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

9. Përjashtohen nga përfitimi i subvencionit të ndërmarrjeve sociale ato organizata jofitimprurëse që kanë përfituar në 3 vjetët e fundit nga programi i mbështetjes financiare të buxhetit të shtetit, fondi social.

10. Vlera totale e ndihmës së dhënë një ndërmarrjeje sociale, e siguruar nga të gjitha format e mbështetjes së ndihmës shtetërore, përfshirë dhe format e mbështetjes nga buxheti i shtetit, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, nuk do të kalojë shumën 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë për një periudhë prej tre vjetësh.

11. Ndërmarrja sociale përfituese e formave të subvencioneve, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, plotëson deklaratën për çdo ndihmë *"de minimis"*, të miratuar nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, të përfituar gjatë dy viteve të kaluara dhe vitit financiar në vazhdim.

12. Ministri përgjegjës për çështjet sociale ngre komisionin vlerësues të kërkesave të ndërmarrjeve sociale për përfitimin e subvencioneve dhe përcakton përbërjen dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të tij.

13. Ndërmarrjet sociale, që përfitojnë subvencione raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, lidhur me përdorimin e subvencionit të përfituar, sipas formatit të raportimit, të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

14. Periudha e raportimit të veprimtarisë është viti kalendarik, i cili është në përputhje me vitin financiar të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, sipas produktit përkatës, të parashikuar në programin buxhetor afatmesëm "Përkujdesje sociale".

16. Subvencionet e miratuara dhe marrëdhëniet juridike të krijuara në zbatim të vendimit nr. 174, datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale për periudhën 2023–2025", vijojnë të zbatohen deri në përfundimin e tyre, sipas kushteve, afateve dhe akteve individuale të nxjerra në bazë të tij.

17. Ngarkohen ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 233, datë 1.4.2026

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 643, DATË 5.10.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES DHE TË MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT PËR PLANIFIKIMIN KOMBËTAR SPITALOR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 55/2022, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1, e vendimit nr .643, datë 5.10.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Komitetit për Planifikimin Kombëtar Spitalor", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Komitetit për Planifikimin Kombëtar Spitalor, si organ këshillimor pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë, me 9 (nëntë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- Prof. Alban Dibra, mjek kardiolog;
- Prof. Roland Bani, mjek familjeje;
- Prof. Alketa Qosja, mjek neonatologe;
- Prof. Altin Veshti, mjek kardiokirurg;
- Prof. Arben Rroji, mjek radiolog;
- Prof. Helidon Nina, mjek kirurg onkolog;
- Dr. Leon Kaza, mjek gjinekolog;
- Dr. Skënder Brataj, mjek urgjence;
- Znj. Rudina Degjoni, ekonomiste.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 235, datë 1.4.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 712, DATË 31.7.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT PUBLIK PËR TË DREJTËN E PESHKIMIT NË UJËRAT E BRENDSHME, FORMAT E TJERA TË PESHKIMIT NË DET, PA PËRDORIMIN E MJETEVE LUNDRUESE, DHE ZHVILLIMIN E AKUAKULTURËS NË SIPËRFAQE PUBLIKE, TOKËSORE DHE UJORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 52, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 712, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 11/1, 12 dhe 12/1 shfuqizohen.

2. Pikat 13, 14 e 15 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"13. Për kryerjen e procedurave të konkurrimit publik për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit në ujërat e brendshme, për format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese dhe për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore, ngrihet Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave me urdhër të ministrit. Për ujëmbledhësit e bujqësisë në përgjegjësi administrimi të njësive të vetëqeverisjes vendore, Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave ngrihet me urdhër të titullarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, nën juridiksionin territorial të së cilës ndodhet ujëmbledhësi i bujqësisë.

14. Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave, në përmbushje të detyrimeve të tij, kryen procedurat e mëposhtme:

a) Shkarkon dokumentacionin e depozituar në format elektronik gjatë procesit të aplikimit nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania", ruan një kopje elektronike të tij dhe harton procesverbalin e hapjes së konkurrimit;

b) Kryen procesin e vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike edhe në rastin kur për objektin ujor të shpallur për konkurrim është paraqitur një konkurrues i vetëm;

c) Verifikon nëpërmjet institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, nëse subjekti konkurrues mbart detyrime financiare dhe nëse ndaj tij ka masa administrative;

ç) Në rastin kur konstatohen pasaktësi në kërkesën e paraqitur, kërkuesit i kërkohet në rrugë zyrtare që të korrigjojë pasaktësitë ekzistuese në dokumentacionin e kërkuar, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit. Kur kërkuesi plotëson pasaktësitë në dokumentacionin brenda afatit të përcaktuar, kërkesa quhet e regjistruar nga dita që është dërguar. Kur kërkuesi nuk i plotëson brenda afatit të caktuar, kërkesa quhet se nuk është regjistruar;

d) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shkronjën "ç" të kësaj pike, vlerëson me pikë dhe merr vendim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike, sipas çdo elementi konkurrimi;

dh) Harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruhen pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit, si dhe renditja e subjekteve të kualifikuara sipas vlerësimit me pikë;

e) Paraqet te titullari procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit dhe vendimin për miratimin e procedurës brenda 7 (shtatë) ditëve;

ë) Njoftimi për rezultatet e konkurrimit dërgohet për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe njoftimi vlerësohet i kryer brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e botimit.

15. Pas përfundimit të procedurave të sipërpërmendura, titullari i institucionit lidh kontratën për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar dhe të miratuar në procesin e konkurrimit me subjektin fitues brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e përfundimit të shqyrtimit të ankimit, nëse ka.".

3. Pikat 16 dhe 16/1 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"16. Kontrata tip, e cila lidhet me subjektin fitues, miratohet me urdhër të ministrit.

16/1. Për monitorimin e kontratave ngarkohet struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave. Procesi i monitorimit të kontratave përcaktohet me udhëzim të ministrit.".

4. Pikat 17, 17/1 dhe 17/2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"17. Subjektet konkurruese kanë të drejtën e ankimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në shkronjën "ë", të pikës 14, të këtij vendimi.

17/1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga paraqitja e ankesës, me urdhër të titullarit ngrihet Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, me 3 (tre) anëtarë, që ka në përbërje:

a) një specialist të fushës;

b) një ekonomist;

c) një jurist.

17/2. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave merr vendim, për:

a) pranimin e ankesës, duke rivlerësuar dokumentacionin dhe procedurën në rast se vlerëson se në procedurën konkurruese janë shkelur kriteret procedurale apo ka pasur parregullsi në kryerjen e vlerësimit të kërkesave;

b) mospranimin e ankesës dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Kërkesave, në rast se vlerëson se në procedurën konkurruese nuk janë shkelur kriteret procedurale apo nuk ka pasur parregullsi në kryerjen e vlerësimit të kërkesave.".

5. Pas pikës 17/2 shtohet pika 17/3, me këtë përmbajtje:

"17/3. Shqyrtimi i ankesës përfundon brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit sipas pikës 17 të këtij vendimi. Komisioni merr në shqyrtim njëkohësisht të gjitha ankesat, në rast se ka më shumë se një ankesë, për të njëjtën procedurë konkurrimi dhe për çdo ankesë merr një vendim të veçantë duke njoftuar subjektin ankimues.".

6. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"18. Afati i kontratës për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit në ujërat e brendshme, për format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese është 10 (dhjetë) vjet.".

7. Pas pikës 19 shtohet pika 19/1, me këtë përmbajtje:

"19/1. Për ujëmbledhësit e bujqësisë në përgjegjësi administrimi të njësive të vetëqeverisjes vendore, procedurat e konkurrimit zhvillohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore, nën juridiksionin territorial të së cilës ndodhet ujëmbledhësi i bujqësisë, sipas pikave 5, 5/1, 5/2, 11, 12/2, 13, 14, 15, 16/1, 17/1, 17/2 dhe 18, të këtij vendimi.".

II. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 237, datë 1.4.2026**

## PËR SHPALLJEN E DISA ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E EKONOMISË MALORE NË BASHKINË SARANDË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, "Për paketën e maleve", me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen "Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore" të disa zonave në territorin e Bashkisë Sarandë, si më poshtë vijon:

a) Zona nr. 1, pjesë e fshatit Gjashtë, zona kadastrale 2806, Njësia Administrative Sarandë, Bashkia Sarandë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 22 (njëzet e dy) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

b) Zona nr. 2, pjesë e fshatrave Gjashtë dhe Çukë, zona kadastrale 1430, Njësia Administrative Sarandë, Bashkia Sarandë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 43 (dyzet e tre) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH.

2. Shtrirja, kufijtë dhe pikat e hyrjes e të daljes së këtyre zonave përcaktohen në hartën treguese, sipas sistemit KRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve, që do të zhvillohen në këtë zonë, janë:

a) të zhvillimit ekonomik;

b) të zhvillimit industrial;

c) të zhvillimit turistik.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Sarandë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**



| Zona 1<br>Njësia Administrative Sarandë | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Koordinata X** | **Koordinata Y** | **Nr** | **Koordinata X** | **Koordinata Y** | **Nr** | **Koordinata X** | **Koordinata Y** |
| **1** | 500007.94 | 4419114.93 | **62** | 501524.88 | 4416978.39 | **123** | 500759.49 | 4418057.53 |
| **2** | 500027.35 | 4419108.56 | **63** | 501528.54 | 4416940.72 | **124** | 500740.17 | 4418087.9 |
| **3** | 500052.96 | 4419098.54 | **64** | 501540.75 | 4416917.03 | **125** | 500722.18 | 4418110.06 |
| **4** | 500081.36 | 4419085.44 | **65** | 501558.44 | 4416888.49 | **126** | 500692.09 | 4418152.58 |
| **5** | 500096.6 | 4419075.52 | **66** | 501568.81 | 4416866.62 | **127** | 500664.45 | 4418191.86 |
| **6** | 500108.39 | 4419063.57 | **67** | 501571.25 | 4416859.33 | **128** | 500654.28 | 4418201.57 |
| **7** | 500121.6 | 4419038.07 | **68** | 501494.87 | 4416824.99 | **129** | 500633.55 | 4418220.6 |
| **8** | 500127.7 | 4419025.51 | **69** | 501490.78 | 4416832.33 | **130** | 500613.63 | 4418231.94 |
| **9** | 500137.72 | 4419010.71 | **70** | 501486.2 | 4416841.54 | **131** | 500588.57 | 4418250.81 |
| **10** | 500149.66 | 4418993.25 | **71** | 501480.81 | 4416853.89 | **132** | 500577.19 | 4418259.31 |
| **11** | 500157.28 | 4418978.82 | **72** | 501476.47 | 4416863.1 | **133** | 500571.9 | 4418270.24 |
| **12** | 500163.63 | 4418957.82 | **73** | 501472.81 | 4416874.16 | **134** | 500562.15 | 4418287.25 |
| **13** | 500169.22 | 4418934.79 | **74** | 501465.61 | 4416895.91 | **135** | 500552.39 | 4418295.34 |
| **14** | 500172.78 | 4418923.66 | **75** | 501460.68 | 4416910.59 | **136** | 500538.97 | 4418309.11 |
| **15** | 500176.08 | 4418915.05 | **76** | 501456.61 | 4416931.09 | **137** | 500518.64 | 4418327.33 |
| **16** | 500183.19 | 4418903.16 | **77** | 501442.22 | 4416974.7 | **138** | 500505.63 | 4418347.58 |
| **17** | 500196.54 | 4418881.73 | **78** | 501433.68 | 4416994.95 | **139** | 500491.41 | 4418364.18 |
| **18** | 500209.95 | 4418865.63 | **79** | 501419.45 | 4417013.58 | **140** | 500480.02 | 4418379.56 |
| **19** | 500245.62 | 4418829.19 | **80** | 501406.02 | 4417033.01 | **141** | 500460.51 | 4418401.63 |
| **20** | 500289.53 | 4418770.89 | **81** | 501399.11 | 4417040.3 | **142** | 500450.14 | 4418414.99 |
| **21** | 500315.75 | 4418737.79 | **82** | 501392.6 | 4417049.61 | **143** | 500434.28 | 4418436.86 |
| **22** | 500350.5 | 4418692.05 | **83** | 501387.72 | 4417060.55 | **144** | 500417.82 | 4418455.08 |
| **23** | 500372.35 | 4418657.63 | **84** | 501382.43 | 4417072.7 | **145** | 500403.18 | 4418473.3 |
| **24** | 500423.17 | 4418593.36 | **85** | 501373.46 | 4417085.69 | **146** | 500396.48 | 4418488.48 |
| **25** | 500486.18 | 4418529.59 | **86** | 501362.79 | 4417098.09 | **147** | 500390.99 | 4418503.06 |
| **26** | 500521.24 | 4418488.59 | **87** | 501354.15 | 4417107.46 | **148** | 500376.35 | 4418529.17 |
| **27** | 500574.04 | 4418414.37 | **88** | 501335.59 | 4417135.29 | **149** | 500363.55 | 4418548 |
| **28** | 500639.09 | 4418328.53 | **89** | 501305.6 | 4417181.51 | **150** | 500354.4 | 4418558.32 |
| **29** | 500678.12 | 4418271.85 | **90** | 501297.67 | 4417199.12 | **151** | 500346.47 | 4418571.08 |
| **30** | 500739.92 | 4418197.35 | **91** | 501290.95 | 4417214.92 | **152** | 500330.01 | 4418588.08 |
| **31** | 500795.21 | 4418132.56 | **92** | 501285.46 | 4417225.24 | **153** | 500311.1 | 4418607.52 |
| **32** | 500852.13 | 4418087.22 | **93** | 501272.66 | 4417234.96 | **154** | 500289.76 | 4418632.42 |
| **33** | 500881.41 | 4418004.62 | **94** | 501264.12 | 4417241.64 | **155** | 500274.51 | 4418654.28 |
| **34** | 500897.68 | 4417970.6 | **95** | 501237.28 | 4417278.69 | **156** | 500239.08 | 4418700.44 |
| **35** | 500933.46 | 4417944.69 | **96** | 501229.95 | 4417296.91 | **157** | 500198.43 | 4418743.36 |
| **36** | 500964.36 | 4417905.82 | **97** | 501217.55 | 4417322.42 | **158** | 500172.41 | 4418770.08 |
| **37** | 500990.39 | 4417858.85 | **98** | 501187.66 | 4417370.41 | **159** | 500147.21 | 4418791.94 |
| **38** | 501009.9 | 4417829.7 | **99** | 501178.51 | 4417382.56 | **160** | 500124.44 | 4418817.05 |
| **39** | 501031.05 | 4417807.02 | **100** | 501164.48 | 4417411.1 | **161** | 500104.12 | 4418836.48 |
| **40** | 501042.48 | 4417785.64 | **101** | 501149.23 | 4417440.87 | **162** | 500089.48 | 4418860.78 |
| **41** | 501046.55 | 4417741.1 | **102** | 501133.98 | 4417472.45 | **163** | 500078.1 | 4418883.45 |
| **42** | 501049.81 | 4417695.75 | **103** | 501119.34 | 4417496.75 | **164** | 500078.1 | 4418902.07 |
| **43** | 501061.2 | 4417647.96 | **104** | 501102.87 | 4417524.69 | **165** | 500083.79 | 4418912.6 |
| **44** | 501076.65 | 4417613.95 | **105** | 501094.94 | 4417535.32 | **166** | 500086.23 | 4418927.99 |
| **45** | 501109.18 | 4417572.65 | **106** | 501057.32 | 4417603.65 | **167** | 500078.91 | 4418948.23 |
| **46** | 501140.9 | 4417536.21 | **107** | 501046.64 | 4417623.89 | **168** | 500069.16 | 4418962 |
| **47** | 501175.05 | 4417520.82 | **108** | 501039.02 | 4417639.08 | **169** | 500053.3 | 4418987.2 |
| **48** | 501196.2 | 4417507.87 | **109** | 501033.94 | 4417649.71 | **170** | 500037.55 | 4419009.47 |
| **49** | 501227.44 | 4417447.33 | **110** | 500958.71 | 4417717.53 | **171** | 500034.5 | 4419018.07 |
| **50** | 501258.35 | 4417392.26 | **111** | 500954.64 | 4417746.89 | **172** | 499996.9 | 4419043.38 |
| **51** | 501272.99 | 4417371.2 | **112** | 500946 | 4417767.13 | **173** | 499985.98 | 4419042.2 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **52** | 501297.39 | 4417355.01 | **113** | 500937.06 | 4417786.63 | **174** | 499973.02 | 4419039.41 |
| **53** | 501383.2 | 4417247.71 | **114** | 500924.55 | 4417821.56 | **175** | 499961.85 | 4419043.97 |
| **54** | 501393.36 | 4417233.54 | **115** | 500916.01 | 4417837.95 | **176** | 499953.97 | 4419048.78 |
| **55** | 501400.28 | 4417210.86 | **116** | 500908.08 | 4417859.52 | **177** | 499940.7 | 4419050.42 |
| **56** | 501409.57 | 4417186.32 | **117** | 500898.02 | 4417872.27 | **178** | 499929.52 | 4419051.94 |
| **57** | 501431.94 | 4417153.93 | **118** | 500869.05 | 4417902.03 | **179** | 499920.37 | 4419053.96 |
| **58** | 501471.38 | 4417121.94 | **119** | 500816.92 | 4417973 | **180** | 499913.26 | 4419056.24 |
| **59** | 501492.53 | 4417092.38 | **120** | 500786.93 | 4418007.42 | **181** | 499909.7 | 4419060.29 |
| **60** | 501505.55 | 4417062.82 | **121** | 500777.28 | 4418012.48 | **182** | 499906.4 | 4419063.07 |
| **61** | 501515.11 | 4417023.95 | **122** | 500770.16 | 4418026.65 | **183** | 500007.94 | 4419114.93 |



| Zona 2<br>Njësia Administrative Sarandë | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Koordinata X** | **Koordinata Y** | **Nr** | **Koordinata X** | **Koordinata Y** |
| **1** | 502528.31 | 4413934.22 | **31** | 503015.45 | 4413752.78 |
| **2** | 502615.75 | 4413976.79 | **32** | 503013.02 | 4413732.73 |
| **3** | 502632.99 | 4414094.28 | **33** | 503016.68 | 4413721.18 |
| **4** | 502562.79 | 4414207.7 | **34** | 503027.58 | 4413687.15 |
| **5** | 502535.32 | 4414246.18 | **35** | 503033.18 | 4413650.69 |
| **6** | 502536.33 | 4414292.77 | **36** | 503037.77 | 4413620.81 |
| **7** | 502556.66 | 4414298.85 | **37** | 503037.27 | 4413592.45 |
| **8** | 502595.31 | 4414275.57 | **38** | 503036.77 | 4413574.72 |
| **9** | 502654.31 | 4414192.54 | **39** | 503026.61 | 4413551.93 |
| **10** | 502688.9 | 4414171.28 | **40** | 503020.72 | 4413538.25 |
| **11** | 502730.59 | 4414157.12 | **41** | 502994.3 | 4413484.05 |
| **12** | 502775.33 | 4414158.14 | **42** | 502974.48 | 4413446.56 |
| **13** | 502828.2 | 4414177.41 | **43** | 502972.46 | 4413431.37 |
| **14** | 502862.36 | 4414207 | **44** | 502970.93 | 4413421.24 |
| **15** | 502907.9 | 4414234.56 | **45** | 502975.52 | 4413409.59 |
| **16** | 502966.47 | 4414239.45 | **46** | 502982.13 | 4413397.44 |
| **17** | 502970.02 | 4414239.4 | **47** | 503030.94 | 4413357.94 |
| **18** | 502973.59 | 4414226.99 | **48** | 502815.38 | 4413260.61 |
| **19** | 502979.19 | 4414198.89 | **49** | 502830.86 | 4413219.29 |
| **20** | 502992.43 | 4414148.76 | **50** | 502839.82 | 4413175.53 |
| **21** | 503000.32 | 4414116.85 | **51** | 502844.71 | 4413147.98 |
| **22** | 503012.32 | 4414060.9 | **52** | 502842.28 | 4413137.45 |
| **23** | 503016.91 | 4414008.74 | **53** | 502742.23 | 4413072.58 |
| **24** | 503018.45 | 4413988.48 | **54** | 502691.76 | 4413140.63 |
| **25** | 503025.07 | 4413958.61 | **55** | 502635.59 | 4413242.72 |
| **26** | 503032.47 | 4413921.74 | **56** | 502582.77 | 4413525.27 |
| **27** | 503044.08 | 4413856.72 | **57** | 502551.59 | 4413697.26 |
| **28** | 503046.54 | 4413810.53 | **58** | 502535.68 | 4413855.26 |
| **29** | 503041.06 | 4413787.43 | **59** | 502531.12 | 4413906.99 |
| **30** | 503025.2 | 4413767.98 | **60** | 502528.31 | 4413934.22 |

**KËRKESË**
**Nr. 378/4, datë 30.3.2026**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 662, datë 13.10.2022, 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të 'Unazës së madhe' Tiranë nga 'Sheshi Shqiponja' – 'Bulevardi i Ri' dhe 'Rikualifikimi i Unazës Lindore 4,5,6'", i ndryshuar", me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 19,812,309.80 (nëntëmbëdhjetë milionë e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e treqind e nëntë pikë tetëdhjetë) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit "arë" dhe "truall" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë";

- Vlerësimi për pasurinë e llojit "ndërtesë" me funksion social-ekonomike është bërë bazuar në situacionin e punimeve dhe vlerësimi për pasurinë e llojit "ndërtesë" me funksion banimi është bërë bazuar në VKM-në nr.138, datë 23.8.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 19,812,309.80 (nëntëmbëdhjetë milionë e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e treqind e nëntë pikë tetëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
**Ermal Shena**

LISTA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT PËR PROJEKTIN, "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 662, DATË 13.10.2022, 'PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'RISHIKIMI I PROJEKTIT PËR SEGMENTIN RRUGOR TË VAZHDIMIT TË 'UNAZËS SË MADHE' TIRANË NGA 'SHESHI SHQIPONJA' – 'BULEVARDI I RI' DHE 'RIKUALIFIKIMI I UNAZËS LINDORE 4,5,6'", I NDRYSHUAR"

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Të dhënat e pasurisë | | | Tokë truall | | | | Tokë "arë" | | | | Ndërtesë soc. ek. | | | Objekt banimi | | | | Vlera totale (lekë) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Zona kadastrale | Numri i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sip. totale m² | Sipërfaqja e shpronësuar (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera lekë | Sip. totale m² | Sipërfaqja e shpronësuar (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera lekë | Sip. totale m² | Sipërfaqja e shpronësuar (m²) | Vlera sipas preventivit lekë | Sip. totale m² | Sipërfaqja e shpronësuar (m²) | Çmimi m² | Vlera lekë | | |
| 1 | Ramazan | Ibrahim | Avdiu | 8110 | 7/68 | Truall | 435.20 | 23 | 23,703.00 | 545,169.00 | | | | - | | | | | | | | 545,169.00 | |
| 2 | Medi | Agim | Kaca | 8110 | 7/43 | Truall | 376.30 | 45 | 23,703.00 | 1,066,635.00 | | | | - | | | | | | | | 1,066,635.00 | |
| 3 | Arben | Myfit | Duro | 8120 | 5/973 | Truall | 598.10 | 44.8 | 29,106.00 | 1,303,948.80 | | | | - | | | | | | | | 1,303,948.80 | |
| 4 | Arben | Myfit | Duro | 8120 | 5/971 | Truall | 33.54 | 33.5 | 29,106.00 | 975,051.00 | | | | - | | | | | | | | 975,051.00 | |
| 5 | Avni | Hasan | Misku | 8110 | 5/668 | Truall + ndërtesë | 163.00 | 100.2 | 23,703.00 | 2,375,040.60 | | | | - | | | | 63.90 | 63.90 | 60,959.00 | 3,895,280.10 | 6,270,320.70 | |
| 6 | Skender | Hysen | Dervishi | 8120 | 4/198 | Truall | 170.00 | 24.5 | 29,106.00 | 713,097.00 | | | | - | | | | | | | | 713,097.00 | |
| 7 | Besim | Kapllan | Aruçi | 8120 | 3/23 | Truall | 301.80 | 10.7 | 29,106.00 | 311,434.20 | | | | - | | | | | | | | 311,434.20 | |
| 8 | Xhevahir | Hasan | Popshini | 8120 | 3/500 | Truall | 160.30 | 19 | 29,106.00 | 553,014.00 | | | | - | | | | | | | | 553,014.00 | |
| 9 | Arben | Ded | Ndoci | 8310 | 10/977 | Truall | 10.00 | 10 | 31,219.00 | 312,190.00 | | | | - | | | | | | | | 312,190.00 | |
| 10 | Agim | Çerçis | Selimi | 8310 | 2/84-ND10 | Ndërtesë | | | | | | | | | 28.64 | 28.64 | 1,288,018.30 | | | | | 1,288,018.30 | Shteti është pronar i truallit 2/84 mbi të cilën është ndërtesa 2/84-ND10 |
| 11 | Dashnor | Ramis | Nako | 3976 | 136/463 | Arë | | | | | 1000 | 187.4 | 448.00 | 83,955.20 | | | | | | | | 83,955.20 | |
| 12 | Agim | Avdyl | Qazimi | 3976 | 136/127 | Truall | 407.2 | 187.4 | 479 | 89,764.60 | | | | | | | | | | | | 89,764.60 | Godinë banimi 2 kt. skp. 93.4 m², sk1. 100.2 m² |
| 13 | Sherif | Eqerem | Ahmati | 2884 | 224 | Truall | 300 | 205.2 | 3560 | 730,512.00 | | | | | | | | 107.1 | 107.1 | 52,000.00 | 5,569,200.00 | 6,299,712.00 | Me ref. 005084 dhe vendim nr. 50 dt. 7.2.2024, regjistrohet godinë banimi 1 kt. kati përdhe 107.1 m² + parcelë ndërtimore 300 m² miratuar me VKM-në nr. 827, dt. 30.9.2020. |
| | SHUMA TOTALE | | | | | | | | | 8,975,856.20 | | | | 83,955.20 | | | 1,288,018.30 | | | | 9,464,480.10 | 19,812,309.80 | |

| | Formati 61x86/8 |
|---|---|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2026/04/03 13:30:14 +02'00'
cffd3b6c2a464559ac8277cdcbabad382

Çmimi 192 lekë

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*